FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 74

Tiranë – E mërkurë, 22 maj 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 15.5.2019	Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm.....	5459

VENDIM
Nr. 319, datë 15.5.2019

PËR KUFIZIMET PËR PRODHIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E DISA KIMIKATEVE DHE ARTIKUJVE TË CAKTUAR TË RREZIKSHËM[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e listës së kimikateve dhe të artikujve të caktuar të rrezikshëm, këtej e në vijim të quajtur "lista e kufizimeve", sipas shtojcave I e II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ky vendim nuk zbatohet për kimikatet dhe substancat e përcaktuara në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", dhe për substancat e përdorura në produktet kozmetike.

3. Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

4. Çdo kimikat ose artikull, i cili kufizohet sipas "listës së kufizimeve", të shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të prodhohet, vendoset në treg ose përdoret nëse është në përputhje me kushtet dhe afatet e atij kufizimi, të përcaktuara në këtë shtojcë.

5. Personat fizikë dhe juridikë që prodhojnë, importojnë, vendosin në treg një kimikat ose artikull, i cili kufizohet sipas "listës së kufizimeve", të shtojcës I, të këtij vendimi, njoftojnë ministrinë përgjegjëse për mjedisin mbi aktivitetet që kryejnë përpara datës 1 dhjetor 2019 dhe, me qëllim shtyrjen e afateve të kufizimeve të përcaktuara në shtojcën I, të këtij vendimi, dorëzojnë informacionin, si më poshtë vijon:

a) Identitetin e prodhuesit, importuesit ose përdoruesit profesional sikurse specifikohet në seksionin 1, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Identitetin e substancës, sikurse specifikohet në seksionin 2, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) Të dhënat për prodhimin dhe përdorimin/et e substancës, sikurse specifikohet në seksionin 3, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi; ky informacion do të përfaqësojë të gjithë/a përdorimin/et;

ç) Udhëzimet për përdorimin e sigurt të substancës, sikurse specifikohet në seksionin 5, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ministria përgjegjëse për mjedisin, në çdo rast, konfirmon marrjen e njoftimit brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve pune dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë vendosin për propozimin e rishikimit ose jo të afateve për kushtet e kufizimit të substancës përkatëse, jo më vonë se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga marrja e njoftimit.

7. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e ngarkuara në ligjin nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet juridike pas 2 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

[1] Ky vendim përafron pjesërisht rregulloren (KE) nr. **1907/2006,** të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 18 dhjetor 2006, në lidhje me regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve **(*REACH*),** krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve ECHA, që amendon direktivën 1999/45/KE dhe shfuqizon rregulloren e Këshillit (KEE) nr.793/93, si dhe direktivën e Këshillit 76/769/KEE dhe direktivat e Komisionit 91/155/KEE, 93/67/KEE, 93/105/KE dhe 2000/21/KE, dhe shtojcat XVII e VI, të saj. CELEX 32006R1907(version i konsoliduar 9.5.2018).

SHTOJCA I

KAPITULLI 1
LISTA E SUBSTANCAVE QË NDALOHEN DHE KUFIZOHEN (LISTA E KUFIZIMEVE)

Për substancat e listuara në këtë Shtojcë në kuadër të legjislacionit për menaxhimin e kimikateve (nr. 1–58), kufizimet nuk do të zbatohen për depozitimin, mbajtjen, trajtimin, mbushjen në kontejnerë ose transferimin e këtyre substancave nga një kontejner në një tjetër për eksport, me përjashtim të rastit nëse prodhimi i substancës është i ndaluar.

Numri/ Hyrja	Emri i substancës, grupit të substancave ose përzierjeve Numri EC dhe CAS	Kushtet e Kufizimit
1.	**Trefenilet e poliklorinuara (PCT)** *(Polychlorinated terphenyls (PCTs))*	Nuk duhet të vendosen në treg, ose të përdoren: – si substanca; – në përzierje, duke përfshirë vajrat e mbetjeve, ose në pajisje në përqendrime më të mëdha se 50 mg/kg (0.005% të peshës).
2.	**Kloreten (vinil kloridi)** *(Chloroethene (vinyl chloride))* Nr. CAS 75-01-4 Nr. EC 200-831-0	1. Nuk duhet të përdoret si shpërndarës, sprucator në aerosole për çfarëdo lloj përdorimi. 2. Sprajet e aerosolëve që mbajnë substanca si shpërndarës, sprucator, nuk duhet të vendosen në treg.
3.	Substanca ose përzierjet e lëngshme, që plotësojnë kriteret për një ose më shumë klasa rreziku si më poshtë, ose kategoritë e përcaktuara në shtojcën I, të vendimit për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve: (a) Klasat e rrezikut 2.1 deri në 2.4, 2.6 dhe 2.7, 2.8 tipi A dhe B, 2.9, 2.10, 2.12, 2.13 Kategoritë 1 dhe 2, 2.14 Kategoritë 1 dhe 2, 2.15 tipi A deri në F; (b) Klasat e rrezikut 3.1 deri në 3.6, 3.7 efekte negative për riprodhimin ose zhvillimin human, 3.8 efekte të ndryshme nga efektet narkotike, 3.9 dhe 3.10; (c) Klasa e rrezikut 4.1; (d) Klasa e rrezikut 5.1.	1. Nuk do të përdoren në: – artikuj zbukurues, me qëllimin për të prodhuar dritë ose efekte ngjyrash, p.sh. në llambat dhe tavllat zbukuruese; – lojëra dhe argëtime; – lojëra për një ose më shumë pjesëmarrës ose për çdo artikull të destinuar për t'u përdorur për këtë qëllim madje edhe për qëllime zbukurimi. 2. Artikujt që nuk përputhen me pikën 1, nuk do të vendosen në treg. 3. Nuk do të vendosen në treg nëse përmbajnë një agjent ngjyrues, përveç rastit kur kërkohen për arsye fiskale, ose parfumi, ose të dyja, dhe nëse: – paraqesin një rrezik për rrugët e frymëmarrjes dhe janë etiketuar me R65 ose H304, dhe, – mund të përdoren si lëndë djegëse (fuel) në llambat dekorative; 4. Llambat dekorative, të destinuara për furnizim për publikun e

		gjerë nuk do të vendosen në treg, nëse nuk janë në përputhje me Standardet Evropiane për vajrat e llambave dekorative (EN 14059) të miratuara nga Komiteti Evropian për Standardizimet (CEN.), *dhe/ose me Standardet Shqiptare (SSH), që janë adoptime të Standardeve Evropiane (EN), të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS)*". 5. Furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg dhe në përputhje me vendimin mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve se artikujt e mëposhtëm etiketohen dhe shënjohen në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme si vijon: a) llambat me gaz, të etiketuara me R65 ose H304, të destinuara për furnizim për publikun e gjerë, duhet të etiketohen me paralajmërimin: "Mbani llambat e mbushura me këtë lëng, larg fëmijëve"; dhe 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të shënjohen me paralajmërimin: "Vetëm një gllënjkë e vajit të llambës – ose edhe thithja e fitilit të llambave – mund të çojë në kërcënimin me jetë nga dëmtimi i mushkërive"; b) 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, lëngjet e ndezjes së skarës të destinuara për furnizim për publikun e gjerë, duhet të etiketohen me R65 ose H304 dhe shënohen me paralajmërimin: "Vetëm një gllënjkë nga lëngu që përdoret për ndezjen e skarës mund të çojë në kërcënimin me jetë nga dëmtimi i mushkërive"; c) 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, vajrat e llambës dhe lëngjet ndezëse të skarës të etiketuar me R65 ose H304, të destinuara për furnizim për publikun e gjerë, vendosen në treg vetëm janë të ambalazhuar me kontejnerë të zinj opake (jo të tejdukshëm), me vëllim që nuk e kalon 1 litër. 6. Personat fizike dhe juridike që vendosin në treg për herë të parë vajra llambe dhe filtra skare, të etiketuar me R65 ose H304, deri në datën 1 korrik 2019 dhe çdo vit pasues, paraqesin pranë Zyrës së Kimikateve, të dhëna mbi alternativa më të sigurta për vajrat e llambave dhe lëngjet e ndezjes së skarës.
4.	**Tre Fosfati i (2,3 dibrompropilit)** *(Tris (2,3 dibromopropyl) phosphate)* Nr. CAS 126-72-7	1. Nuk do të përdoret në artikuj tekstilesh si rrobat, ndërresat dhe teshat, të destinuara për t'u qenë në kontakt me lëkurën. 2. Artikujt, e referuar në pikën 1 me sipër, që përmbajnë këtë substancë nuk do të vendosen në treg.
5.	**Benzeni** *(Benzene)* Nr. CAS 71-43-2 Nr. EC 200-753-7	1. Nuk do të përdoret në lodra, ose pjesë lodrash, ku përqendrimi i benzenit në gjendje të lirë, është më i madh se 5 mg/kg (0,0005 %) të peshës së lodrës, ose të pjesës së lodrës. 2. Lodrat, ose pjesët e lodrave, ku përqendrimi i benzenit në gjendje të lirë është më i madh se 5 mg/kg, nuk do të vendosen në treg. 3. Nuk do të vendosen në treg, ose nuk do të përdoren: – si substancë;

		– si përbërës i substancave të tjera, ose në përzierje, me përqendrim të njëjtë, ose më të madh se 0,1% të peshës. 4. Ndalimet e parashikuara në pikën 3 më sipër, nuk zbatohen për: a) lëndët djegëse motorike që mbulohen nga legjislacioni specifik për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel; b) substancat dhe përzierjet për përdorim në proceset industriale që nuk lejojnë çlirimin e benzenit në sasi që kalojnë normat e vendosura në legjislacionin ekzistues; c) gazin natyror të vendosur në treg për përdorim nga konsumatorët, duke siguruar se përqendrimi i benzenit qëndron nën 0,1 % volum/volum.
6.	**Fibrat e Asbestit** a) Krocidoliti *(Crocidolite)* Nr. CAS 12001-28-4 b) Amositi *(Amosite)* Nr. CAS 12172-73-5 c) Antofiliti *(Anthophyllite*) Nr. CAS 77536-67-5 d) Aktinoliti *(Actinolite)* Nr. CAS 77536-66-4 e) Tremoliti *(Tremolite)* Nr. CAS 77536-68-6 f) Krisotili **(Chrysotile)* Nr. CAS 12001-29-5 Nr. CAS 132207-32-0	1. Prodhimi, vendosja në treg dhe përdorimi i fibrave të asbestit, artikujve dhe përzierjeve që i përmbajnë këto fibra të shtuara në mënyrë të qëllimshme, është i ndaluar. Paragrafi i parë nuk zbatohet deri më 1 korrik 2025 për përdorim në ato instalime të diafragmave të tilla ose të krizotileve të përdorura ekskluzivisht në mirëmbajtjen e diafragmave të tilla, me kusht që një përdorim i tillë të kryhet në përputhje me kushtet e një leje të vendosur në përputhje me Legjislacionin për lejet e mjedisit. Çdo përdorues (*downstream user*) që përfiton nga një përjashtim i tillë, brenda datës 31 janar të çdo viti kalendarik do të dërgojë në AKM/DRM përkatëse në të cilin gjendet instalimi përkatës i elektrolizës, një raport që tregon sasinë e krizotilit të përdorur në diafragmat në përputhje me atë përjashtim. AKM/DRM i dërgon një kopje të raportit Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin. Në rastin kur, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve AKM/DRM kërkon monitorimin e krizotileve në ajër nga përdoruesit (*downstream user*), rezultatet e dala nga ai monitorim do të përfshihen në raport. 2. Përdorimi i artikujve që përmbajnë fibra asbesti, referuar në pikën 1, që kanë qenë të instaluar dhe/ose në shërbim përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vazhdojnë të lejohen derisa të asgjësohen ose të arrijnë fundin e jetëgjatësisë së shërbimit të tyre. Kur arrijnë në fund të jetës, këto artikuj asgjësohen në konsulencë të plotë me Drejtorinë përkatëse Rajonale të Mjedisit ose Inspektoratin e mjedisit dhe sipas legjislacionit specifik për mbetjet e rrezikshme. Ndërhyrjet e çdo lloji (heqje, inkapsulim etj.), realizohen nga kompani të specializuara dhe të certifikuara për punime në rehabilitimin e zonave me azbest. Çdo asgjësim/hedhje i/e paautorizuar dhe në mungesë të dijenisë dhe autorizimit nga autoritetet përkatëse, dënohet si krim mjedisor sipas kodit penal. 3. Pa anashkaluar legjislacionin që mbulon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, vendosja në treg dhe përdorimi i fibrave të asbestit, i lejuar sipas rasteve përjashtimore më sipër, do lejohet vetëm nëse furnizuesit përpara vendosjes në treg do të sigurojnë etiketimin e atij artikulli në përputhje me kërkesat e parashikuara në tabelën 7, të shtojcës II, të këtij vendimi.
7.	**Tri(aziridinil) fosfinoksid** *(Tris(aziridinyl)phosphinoxide)* Nr. CAS 545-55-1 Nr. EC 208-892-5	1. Nuk do të përdoret në artikuj tekstilesh, si rrobat, ndërresat dhe teshat, të destinuara për t'u vendosur në kontakt me lëkurën. 2. Artikujt e referuar në pikën 1, që përmbajnë këtë substancë nuk do të vendosen në treg.
8.	**Polibrom Bifenil** (*Polybromobiphenyls);*	

	Bifenile të polibrominuara (PBB) *(Polybrominatedbiphenyls) (PBB)* Nr. CAS 59536-65-1	a) Nuk do të përdoren në artikuj tekstilesh, si rrobat, ndërresat dhe tesha, të destinuara për t'u vendosur në kontakt me lëkurën. b) Artikujt e referuar në pikën 1, që përmbajnë këtë substancë nuk do të vendosen në treg.
9.	a) Pudër sapuni "*Soap bark powder*" që nxirret nga pema e sapunit (*Quillaja saponaria*) dhe derivatet e tij që përmbajnë sapunë Nr. CAS 68990-67-0 Nr. EC 273-620-4 b) Pudër që nxirret nga rrënjët e bimëve *Helleborus viridis dhe Helleborus niger.* c) Pudër që nxirret nga rrënjët e *Veratrum viridis* dhe *Veratrum nigrum* d) Benzidine dhe/ose derivatet e tij Nr. CAS 92-87-5 Nr. EC 202-199-1 e) o- Aldehid i Nitrobenzenit *(o-Nitrobenzaldehyde)* Nr. CAS 552-89-6 Nr. EC 209-025-3 f) Pudër e nxjerrë nga druri	1. Nuk do të përdoren, në raste lojërash për argëtime dhe rrengje, ose në përzierje dhe artikuj me qëllimin për t'u përdorur si të tillë (për shembull si përbërës i pluhurit të teshtimës ose bombave kutërbuese). 2. Produktet dhe përzierjet e referuara në pikën 1, që përmbajnë këto substanca, nuk do të vendosen në treg. 3. Ndalimet, e referuara në pikën 1 dhe 2, nuk do të zbatohen për bombat kutërbuese që përmbajnë më pak se 1,5 ml lëng.
10.	a) **Sulfit Amoni** *(Ammonium sulphide)* Nr. CAS 12135-76-1 Nr. EC 235-223-4 b) **Sulfit Hidrogjen Amoni** *(Ammonium hydrogen sulphide*) Nr. CAS 12124-99-1 Nr. EC 235-184-3 c) **Polisulfit Amoni** *(Ammonium polysulphide)* Nr. CAS 9080-17-5 EC No 232-989-1	1. Nuk do të përdoren, në raste lojërash për argëtime dhe rrengje, ose në përzierje dhe artikuj me qëllimin për t'u përdorur si të tillë (për shembull si përbërës i pluhurit të teshtimës ose bombave kutërbuese). 2. Produktet dhe përzierjet e referuara në pikën 1, që përmbajnë këto substanca, nuk do të vendosen në treg. 3. Ndalimet, e referuara në pikën 1 dhe 2, nuk do të zbatohen për bombat kutërbuese që përmbajnë më pak se 1,5 ml lëng.
11.	**Estere Volatile të Acidit Bromacetik:** a) **Bromacetat i Metilit** *(Methyl bromoacetate)* Nr. CAS 96-32-2 Nr. EC 202-499-2 b) **Bromacetat i etilit** *(Ethyl bromoacetate)*	1. Nuk do të përdoren, në raste lojërash për argëtime dhe rrengje, ose në përzierje dhe artikuj me qëllimin për t'u përdorur si të tillë (për shembull si përbërës i pluhurit të teshtimës ose bombave kutërbuese). 2. Produktet dhe përzierjet e referuara në pikën 1, që përmbajnë këto substanca, nuk do të vendosen në treg. 3. Ndalimet, e referuara në pikën 1 dhe 2, nuk do të zbatohen për bombat kutërbuese që përmbajnë më pak se 1,5 ml lëng.

	Nr. CAS 105-36-2 Nr. EC 203-290-9 c) **Bromacetat i Propilit** *(Propyl bromoacetate)* Nr. CAS 35223-80-4 **d) Bromacetat i butilit** *(Butyl bromoacetate)* Nr. CAS 18991-98-5 Nr. EC 242-729-9	
12.	**2-Naftilamina dhe kripërat e saj** *(2-Naphthylamine)* Nr. CAS 91-59-8 Nr. EC 202-080-4	Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose në përzierje me përqendrime më të mëdha se 0,1% të peshës.
13.	**Benzidin** *(Benzidine)* Nr. CAS 92-87-5 Nr. EC 202-199-1 dhe kripërat e tij	
14.	**4- Nitrobifenil** *(4-Nitrobiphenyl)* Nr. CAS 92-93-3 Nr. EC Einecs 202-204-7	
15.	**4- Ksenilamin e Aminobifenilit** *(4-Aminobiphenyl xenylamine)* Nr. CAS 92-67-1 Nr. EC Einecs 202-177-1 dhe kripërat e tij	
16.	**Karbonatet e Plumbit:** a) Karbonat neutral i anhidritit $PbCO_3$ *(Neutral anhydrous carbonate)* Nr. CAS 598-63-0 Nr. EC 209-943-4 b) Dyhidroksid-dykarbonat i plumbit 2PbCO3-Pb(OH)2 *(Trilead-bis(carbonate)-dihydroxide)* Nr. CAS 1319-46-6 Nr. EC 215-290-6	1. Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose në përzierje, në rastin kur ka si qëllim përdorimin si bojë. 2. Përdorimi i substancës ose përzierjes në restaurimin dhe mirëmbajtjen e veprave të artit, ndërtesave historike dhe brendësisë së tyre, lejohet në përputhje me dispozitat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) Konventa 13, mbi përdorimin e plumbit të bardhë dhe sulfateve në bojë.
17.	**Sulfatet e Plumbit:** a) $PbSO_4$ Nr. CAS 7446-14-2 Nr. EC 231-198-9 b) Pb_xSO_4 Nr. CAS 15739-80-7 Nr. EC 239-831-0	1. Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose në përzierje, në rastin kur ka si qëllim përdorimin si bojë. 2. Përdorimi i substancës ose përzierjes në restaurimin dhe mirëmbajtjen e veprave të artit, ndërtesave historike dhe brendësisë së tyre, lejohet në përputhje me dispozitat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) Konventa 13, mbi përdorimin e plumbit të bardhë dhe sulfateve në bojë.
18.	**Komponimet e merkurit**	Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose në përzierje, ku substanca ose përzierja ka si qëllim përdorimin për: a) të parandaluar veprimet shkatërruese nga mikroorganizmat,

		bimët apo kafshët në: – trupin e anijeve, – kafazet, pluskueset**,** rrjetat dhe çdo pajisje tjetër e përdorur për peshkim ose për Akuakulturën e midhjeve; – çdo pajisje ose aparaturë pjesërisht ose totalisht e zhytur/e përmbytur. b) ruajtjen e drurit; c) ngopjen e tekstileve të forta industriale dhe fijeve të parashikuara për fabrikim; d) trajtimin e ujërave industriale, pavarësisht përdorimit të tyre.
18a.	**Mërkuri** *(Mercury)* Nr. CAS 7439-97-6 Nr. EC 231-106-7	1. Nuk do të vendoset në treg: a) në termometra që matin temperaturën e trupit; b) në pajisje të tjera matëse të parashikuara për shitje ndaj publikut të përgjithshëm (si manometrat dhe termometrat që nuk kanë si qëllim matjen e temperaturës së trupit). 2. Kufizimi referuar pikës 1, nuk do të zbatohet për pajisjet matëse që kanë qenë në përdorim përpara datës 1 korrik 2019. 3. Kufizimi, referuar pikë 1, b, nuk do të zbatohet, për: a) pajisjet matëse që prej datës 1 dhjetor 2014 kanë një moshë më shumë se 50-vjeçare; b) barometrat (me përjashtim të barometrave që plotësojnë kushtin sipas pikës (a) më sipër deri më 1 korrik 2019; 4. Pajisjet matëse që përmbajnë merkur më poshtë, të destinuara për përdorim industrial dhe profesional nuk do të vendosen në treg pas datës 1 korrik 2019: 1. barometrat; 2. hygrometrat; 3. manometrat; 4. sfigmomanometrat; 5. instrumentat matës që përdoren me pletismograf; 6. tensiometrat; 7. termometrat dhe përdorimet e tjera termometrike joelektrike; Kufizimet do të zbatohen gjithashtu për pajisjet matëse bosh në pikat a, deri në g, të cilat janë tashmë të vendosura në treg, nëse kanë qëllim për t'u mbushur me merkur. 5. Kufizimi në pikën 4, nuk do të zbatohet, për: a) sfigmomanometrat që do të përdoren: (i) në studimet epidemiologjike të cilat janë në proces në datën që i korrespondon 15 ditë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare; (ii) si standarde reference në studimet klinike për validimin e sfigmomamometrave që nuk përmbajnë merkur. b) termometrat që kanë për qëllim vetëm kryerjen e testeve në përputhje me standardet që kërkojnë përdorimin e termometrave me merkur, deri në 1 korrik 2019; c) qelizat e merkurit me pikë të trefishtë, të cilat janë përdorur për kalibrimin e termometrave me rezistencë platini. 6. Pajisjet matëse që përdorin merkur më poshtë, që kanë për qëllim përdorimin profesional dhe industrial nuk do të vendosen në treg pas datës 1 korrik 2019: a) piknometrat që përmbajnë merkur; b) pajisjet matëse me merkur për përcaktimin e pikës së zbutjes. 7. Kufizimet, referuar pikës 4 dhe 6 nuk do të zbatohen, për: a) pajisjet matëse me moshë më shumë se 50-vjeçare. b) pajisjet matëse të cilat janë për t'u shfaqur në ekspozitat publike për qëllime kulturore dhe historike.

19.	**Komponimet e Arsenikut**	1. Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substanca ose në përzierje ku substanca ose përzierja ka si qëllim përdorimin për të parandaluar veprimet shkatërruese nga mikroorganizmat, bimët apo kafshët në: – trupin e anijeve; – kafazet, pluskueset, rrjetat dhe çdo pajisje tjetër e përdorur për peshkim ose Akuakulturën e midhjeve; – çdo pajisje ose aparaturë pjesërisht ose totalisht e zhytur/e përmbytur. 2. Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose në përzierje ku substanca ose përzierja ka si qëllim përdorimin e saj në trajtimin e ujërave industriale, pavarësisht përdorimit të tyre. 3. Nuk do të përdoren në ruajtjen e drurit. Përveç kësaj, druri i trajtuar në këtë mënyrë nuk do të vendoset në treg. 4. Bëjnë përjashtim nga pika 3: a) Në lidhje me substancat dhe përzierjet për ruajtjen e drurit: këto mund të përdoren vetëm në instalime industriale duke përdorur vakum ose presion për ngopjen e drurit në qoftë se janë solucione të përbërjeve inorganike të bakrit, kromit, arsenikut (BKA/CCA) të tipi C dhe nëse janë të autorizuara në përputhje me legjislacionin specifik për produktet biocide. Druri, i trajtuar në këtë mënyrë, nuk do të vendoset në treg përpara se të ketë përfunduar procesi i fiksimit të solucionit mbrojtës/ruajtës. b) Druri i trajtuar me solucion BKA në përputhje me pikën a) më sipër, mund të vendoset në treg për përdorim profesional dhe industrial duke siguruar që tërësia strukturore e drurit garanton sigurinë e njerëzve ose të bagëtisë. Gjatë përdorimit të këtij druri duhet shmangur kontakti me lëkurën. Përdorimi i këtij druri lejohet për qëllimet e mëposhtme: – si trarë për çati në ndërtesa publike dhe bujqësore, zyra, dhe godina industriale; – në ura dhe në punimet në ura; – si lëndë druri për ndërtim në zona të ujërave të ëmbla dhe në ujëra të njëmëlta, p.sh. bankina/jetties dhe ura; – si barriera zhurmash; – në kontrollimin e ortekëve; – në ndërtimin e gardheve mbrojtës dhe barrierave në autostrada; – kur hiqet lëkura e shtyllave për gardhin e gjedhit; – në strukturat mbështetëse të tokës; – transmetuesit e energjisë elektrike;

		– si vend për të fjetur në metro; – si transmetues të fuqisë elektrike dhe si shtylla të telekomunikimit (antena). c) furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg që i gjithë druri i trajtuar, i vendosur në treg të etiketohet në përputhje me legjislacionin mbi klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve dhe të jetë vendosur shprehja shtesë: "Vetëm për përdorim në instalimet industriale dhe profesionale - përmban arsenik". Gjithashtu, çdo dru i vendosur në treg në pako do të mbajë një etiketë që thotë: "Vish doreza kur prek, punon me këtë lloj druri. Vish një maskë mbrojtëse nga pluhuri dhe mbrojtëse të syve kur pret ose punon këtë dru. Mbetjet nga ky dru do të trajtohen si të rrezikshme". d) Druri i trajtuar, referuar pikës "a", më sipër, nuk do të përdoret: – në ndërtime shtëpiake dhe rezidenciale, pavarësisht qëllimit; – në çdo aplikim ku ka një risk kontakti të vazhdueshëm me lëkurën; – në ujëra detare; – për qëllime bujqësore përveç gardheve për bagëtinë dhe përdorime strukturale në përputhje me pikën "b", më sipër; – në çdo aplikim ku druri i trajtuar mund të ketë kontakt me produkte të ndërmjetme ose të përfunduar, të destinuar për përdorim human dhe/ose nga kafshët. 5. Druri i trajtuar me përbërje arseniku i vendosur në treg përpara datës 1 korrik 2019, ose që është vendosur në treg në përputhje me pikën 4 b, më sipër, mund të vazhdojë të qëndrojë në treg dhe të përdoret deri sa të arrijë fundin e jetës së shërbimit. 6. Druri i trajtuar me BKA, tipi C, që ka qenë në përdorim përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ose i vendosur në treg në përputhje me pikën 4: – mund të përdoret ose ripërdoret sipas kushteve që lidhen me përdorimin e tij, referuar pikës 4 b, c dhe d; – mund të vendoset në treg sipas kushteve që lidhen me përdorimin e tij, referuar pikës 4 b, c dhe d. 7. Mund të lejohet që, druri i trajtuar me tipa të tjerë të solucioneve BKA që ka qenë në përdorim përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi: – të përdoret ose ripërdoret, sipas kushteve që lidhen me përdorimin e tij, referuar pikës 4 b, c dhe d; – të vendoset në treg, sipas kushteve që lidhen me përdorimin e tij, referuar pikës 4 b, c dhe d.

20.	**Komponimet Organostanike**	1. Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose përzierje, në rastin kur substancat ose përzierjet luajnë rolin e biocideve, në bojëra me lidhje të lirë. 2. Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose përzierje, në rastin kur substanca ose përzierja shërben si biocid, për të parandaluar ndotjen nga mikroorganizmat, bimët ose kafshët e: a) të gjithë anijeve pavarësisht gjatësisë së tyre të parashikuar për përdorim në dete, bregdete, estuare, liqene, rrugë të brendshme ujore; b) kafazeve, pluskuesve**,** rrjetave dhe çdo pajisje tjetër të përdorura për peshkim ose në akuakulturën e midhjeve; c) çdo pajisjeje ose aparaturë pjesërisht ose totalisht e zhytur. 3. *Standardet Evropiane të CEN dhe/ose Standardet Shqiptare (SSH), që janë adoptime të Standardeve Evropiane (EN), të miratuara nga DPS,* do të përdoren si metoda prove për të demonstruar/treguar përputhshmërinë e artikujve sipas pikës 1 dhe 2. 4. Komponimet organostanike të trizëvendësuara: a) është e ndaluar të përdoren përbërje të tributil kallaji (TBT) dhe trifenilkallaji (TPT), si artikuj, ose pjesë të një artikulli, në sasi ku përqendrimi i kallajit kalon 0,1% (m/m), të peshës së kallajit, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi; b) Ndalimet, referuar pikës 4 a), nuk do të aplikohen për artikujt që janë në përdorim para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi; c) artikujt që nuk përputhen me kushtet e pikës 4 a) nuk do të vendosen në treg pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi. 5. Përbërjet e Dibutilkallajit (DBT): a) Nuk përdoren në përzierje dhe artikuj, të destinuar për përdorim nga publiku i përgjithshëm, pas datës 1 korrik 2019, nëse përqendrimi i kallajit kalon 0,1% (m/m), të peshës së tij; Ndalimet referuar pikës 5 a), nuk zbatohen për artikujt që janë në përdorim përpara datës 1 korrik 2019; b) Artikujt dhe përzierjet që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 5 a) nuk do të vendosen në treg, 1 korrik 2019; c) Ndalimet, referuar pikës 5 a) dhe b), nuk zbatohen për artikujt dhe përzierjet e mëposhtme të destinuara për përdorim nga publiku i përgjithshëm deri në 1 korrik 2019: – izoluesit e temperaturës së dhomës me një ose dy përbërës (izoluesit RTV-1 dhe RTV-2) dhe ngjitësit;

		– bojërat dhe shtresat që përmbajnë përbërje DBT si katalizatorë kur aplikohen mbi artikuj; – Vetëm profilet e poliklorvinileve të buta (PVC) ose të bashkëformuara me PVC të fortë; – Pëlhurë të mbuluara me PVC që përmbajnë përbërës DBT si stabilizues kur përdoren për aplikime në mjedise të jashtme; – Ulluqet dhe tubat e ujit, si dhe material mbulues për çati dhe fasada. d) Ndalimet të cilave iu referuam në pikat 5 a) dhe b), nuk zbatohen në produkte dhe artikuj, të rregulluar nga legjislacioni për produktet në kontakt me ushqimin. 6. Përbërjet e dioktilit të kallajit (Dioktiltin DOT): a) Ndalohet të përdoren në artikujt e mëposhtëm, ose si pjesë e artikujve për furnizim, ose përdorim nga publiku i gjerë pas datës 1 Korrik 2019 në sasi ku përqendrimi i kallajit kalon 0,1% (m/m) sipas peshës së kallajit: – Artikuj tekstilesh të destinuara për të rënë në kontakt me lëkurën; – dorezat; – veshjet e këmbëve (këpucë, sandale etj.) ose pjesë e veshjeve të këmbëve të parashikuara për të hyrë në kontakt me lëkurën; – mbulesa të mureve dhe dyshemeve; – artikuj të kujdesit për fëmijët; – artikujt e higjienës për femrat; – pelena; – komplete kallëpesh vullkanizues me dy komponentë për temperaturë dhome (komplete kallëpesh RTV-2); Ndalimet të cilat i referohen pikës 6 b) nuk zbatohen për artikujt në përdorim përpara datës 1 korrik 2019. b) artikujt që nuk janë në përputhje me kushtet referuar pikës 6 a), nuk do të vendosen në treg, pas datës 1 korrik 2019.
21.	Dy-μ-oksi-dy-n-butilstaniohidroksiboran dibutilkallaj hidrogjen borate, DBB) Nr. CAS 75113-37-0 Nr. EC 401-040-5	Nuk do vendoset në treg, ose përdoret, si një substancë, ose në përzierje me një përqendrim më të madh ose të barabartë se 0,1% të peshës. Këto ndalime nuk zbatohen në rastin kur kjo substancë (DBB), ose përzierjet që e përmbajnë atë, kanë si qëllim të vetëm konvertimin në artikuj, ku substanca nuk do të ketë përqendrim më të madh ose të barabartë se 0,1% (m/m).
22.	**Pentaklorofenol dhe kripërat dhe esteret e tij** *(Pentachlorophenol and its salts and esters)* Nr. CAS 87-86-5 Nr. EC 201-778-6	Nuk do vendoset në treg, ose përdoret: – si një substancë, ose – si përbërës në substanca të tjera, ose në përzierje, me një përqendrim më të madh ose të barabartë se 0,1% të peshës.

23.	**Kadmium** dhe komponimet e tij *(Cadmium and its components)* Nr. CAS 7440-43-9 Nr. EC 231-152-8	Për qëllime të kësaj pike, kodet dhe kapitujt në kllapa katrore janë kodet doganore sipas Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave. 1. Nuk do të përdoren në përzierje dhe artikuj të prodhuar nga polimeret e mëposhtëm sintetike organike(tani e tutje referuar si materiale plastike): – polimere ose bashkëpolimere të vinil kloride (PVC) [3904 10] [3904 21]; – poliuretan (PUR), [3909 50]; – polietilen me dendësi të ulët (LDPE), me përjashtim të polietilenit me dendësi të ulët të përdorur për prodhimin e serisë kryesore të ngjyrosur, [3901 10]; – acetat celuloze (CA), [3912 11]; – butirat acetat celuloze (CAB), [3912 11]; – rezinat epokside, [3907 30]; – rezinat melamine - rezina me formaldehid (MF) [3909 20]; – Rezinat urea; rezinat me formaldehid (UF), [3909 10]; – poliestere të pangopur (UP), [3907 91]; – Tereftalat polietileni (PET), [3907 60]; – Tereftalat polibutileni (PBT); – polistiren transparent/për qëllime të përgjithshme, [3903 11]; – akrilonitril metilmetakrilat (AMMA); – polietilen me lidhje transversale (VPE); – polistiren me ndikim/efekt të madh; – polipropilen (PP) [3902 10]. Përzierjet dhe artikujt e prodhuar nga materialet plastike të listuar më sipër, nuk do të vendosen në treg nëse përqendrimi i kadmiumit (i shprehur si metal Cd) është i barabartë, ose më i madh se 0.001% e peshës së materialit plastik. Pa e anashkaluar, nënparagrafi i dytë nuk zbatohet për artikujt e vendosur në treg para datës 1 korrik 2019 Nënparagrafi i parë dhe i dytë, më sipër, zbatohet pa rënë ndesh me legjislacionin specifik që rregullon ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet. 2. Nuk do përdoret ose vendoset në treg në bojërat me kode [3208][3209], në rastet kur përqendrimi kadmiumit (i shprehur

si metal Cd), është më i madh se 0,01 % e peshës.

Bojërat që kanë një përmbajtje zinku, që e tejkalon 10% të peshës së bojës, përqendrimi i kadmiumit (i shprehur si metal Cd), nuk duhet të jetë më i madh se 0,1 % e peshës.

Artikujt e lyer, nuk vendosen në treg nëse përqendrimi i kadmiumit (i shprehur si metal Cd), është i barabartë ose më i madh se 0,1 % e peshës së bojës, në artikujt e lyer.

3. Pikat 1 dhe 2, nuk zbatohen për artikujt e ngjyrosur me përzierje që përmbajnë kadmium për arsye sigurie.

4. Pika 1, paragrafi i dytë, nuk zbatohen për:

– Përzierjet e prodhuara nga mbetjet PVC, tani e tutje referuar si "PVC e rikuperuar";

– Përzierjet dhe artikujt që përmbajnë PVC të rikuperuar, nëse përqendrimi i tyre i Kadmiumit (i shprehur si metal Cd) nuk e tejkalon 0.1% të peshës së materialit plastik në përdorimet e PVC së fortë si më poshtë;

a) profile dhe shtresa të forta për përdorime në ndërtesa;
b) dyert, dritaret, qepenat, muret, grilat e dritareve, gardhet dhe ulluqet e çative;
c) kuvertat dhe tarracat;
d) kanalet e kabllove;
e) tubat për ujin jo të pijshëm nëse PVC e rikuperuar është përdorur në shtresën e mesme të një tubi shumështresor dhe është e mbuluar plotësisht me një shtresë PVC të prodhuar kohët e fundit në përputhje me pikën 1 më sipër.

Furnizuesit, përpara vendosjes në treg për herë të parë të përzierjeve dhe artikujve që përmbajnë PVC të rikuperuar, sigurojnë se ato janë shënuar në mënyrë të dukshme, qartësisht e lexueshme dhe e fiksuar mirë si më poshtë: *"Përmban PVC të rikuperuar*" ose me piktogramin si më poshtë:

Përjashtimet referuar pikës 4, do të rishikohen në veçanti me qëllim reduktimin e vlerave limit për kadmiumin dhe rivlerësimin e përjashtimeve për përdorimet e listuara në pikat (a) deri në (e), në përputhje me pikën 3, të nenit 22 të ligjit për menaxhimin e kimikateve.

5. Për qëllime të kësaj hyrje, 'veshje/plating kadmiumi' nënkupton çdo depozitim ose veshje të kadmiumit metalik në një sipërfaqe metalike.

		Nuk do të përdoret për veshje me kadmium të artikujve metalike ose komponentëve të artikujve të përdorur në sektorët/aplikimet e mëposhtme: a) pajisje dhe makineri për: – prodhimin e ushqimit [8210], [8417 20], [8419 81], [8421 11], [8421 22], [8422], 8435], [8437], [8438], [8476 11]; – bujqësi [8419 31], [8424 8], [8432], [8433], [8434] [8436]; – ftohje dhe ngrirje [8418]; – printime dhe lidhjen e librave [8440], [8442], [8443]; b) pajisje dhe makineri për prodhimin e: – të mirave shtëpiake, [7321], [8421 12], [8450], [8509], [8516]; – mobilieve, [8456], [8466], [9401], [9402], [9403], [9404]; – sanitareve [7324]; – impianteve të ngrohjes qendrore dhe të ajrit të kondicionuar [7322], [8403], [8404], [8415]. Në çdo rast, pavarësisht përdorimit ose qëllimit të tyre final të parashikuar, vendosja në treg e artikujve ose komponentëve të këtyre artikujve të veshur me kadmium në sektorët/aplikimet e listuar në pikat 5 a) dhe b) më sipër, është e ndaluar. 6. Dispozitat e referuara në pikën 5, zbatohen edhe për artikujt e veshur me kadmium ose komponentët e këtyre artikujve, kur përdoren në sektorët/përdorimet e listuara në pikat (a) dhe (b) më poshtë dhe për artikujt e prodhuar në sektorët e listuar në pikën (b) si më poshtë: a) pajisje dhe makineri për prodhimin e: – letrës dhe kartonit, [8419 32], [8439], [8441]; – tekstileve dhe veshjeve [8444], [8445], [8447], [8448], [8449], [8451], [8452]; b) pajisje dhe makineri për prodhimin e: – makinerive dhe pajisjeve të trajtimit industrial [8425], [8426], [8427], [8428], [8429], [8430], [8431]; – automjeteve për transport rrugor dhe automjeteve për bujqësi *[kapitulli 87]*; – trenave, kamionëve *[kapitulli 86]*; – anijeve *[kapitulli 89]*; 7. Kufizimet në pikat 5 dhe 6, nuk zbatohen për:

		– artikujt dhe komponentët e artikujve të përdorur në sektorët aeronautike, minerare, aerohapësirë, bërthamore dhe në det, aplikimet e të cilëve kërkojnë standarde të larta sigurie dhe në pajisje sigurie në automjetet rrugore dhe bujqësore, trenat, kamionët dhe anijet; – kontaktet elektrike në çdo sektor përdorimi, ku është e nevojshme të sigurohet besueshmëria e kërkuar për aparatin ku ato janë instaluar. 8. Nuk do të përdoren në mbushësit e saldimit në përqendrim të barabartë ose më të madh se 0,01% e peshës. Mbushësit e saldimit nuk do vendosen në treg nëse përqendrimi i kadmiumit (i shprehur si metal Cd) është i barabartë me ose më i madh se 0,01% e peshës. Për qëllim të këtij paragrafi "saldimi" nënkupton një teknikë bashkimi që përdor aliazhet dhe ndërmarrët në temperaturë mbi 450 ° C. 9. Pika 8, nuk zbatohet për mbushësit e saldimit të përdorur në përdorimet për mbrojtje dhe në aeronautikë dhe për mbushësit e saldimit të përdorur për arsye sigurie. 10. Nuk do përdoret ose vendoset në treg nëse përqendrimi është i barabartë, ose më i madh se 0.01% e peshës së metalit në: (*a) rruaza metalike dhe komponentë të tjerë metalike për bërjen e bizhuterive;* *(b) pjesë metalike të bizhuterive dhe bizhuterive të imituara, si dhe aksesoreve të flokëve duke përfshirë:* i. *Byzylykë, varëse dhe unaza;* ii. *Bizhuteri pirsingu;* iii. *Ora dore dhe bizhuteri dore/kyçi;* iv. *Karfica dhe mansheta.* *11. Pika 10, nuk do zbatohet për artikuj që vendosen në treg përpara datës 1 korrik 2019 dhe për bizhuteri që janë më të vjetra se 50 vjet, më 1 korrik 2019.*
24.	**Metani i Monometil — tetraklorodifenilit;** *(Monomethyl — tetrachlorodiphenyl methane)* Nr. CAS 76253-60-6 Emri tregtar: Ugilec 141	1. Nuk do vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose në përzierje. Artikujt që përmbajnë këtë substancë nuk do vendosen në treg. 2. Ndalimet referuar pikës 1, nuk do të zbatohen: a) në rast se impianti ose makineria është në shërbim që nga data 18 qershor 1994, derisa ky impiant ose makineri të dalë nga përdorimi; b) në rast të mirëmbajtjes së impiantit dhe makinerisë në shërbim që nga data 18 qershor 1994. duke pasur si qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, përdorimi i këtyre impianteve ose makinerive mund të ndalohen përpara se të dalin nga përdorimi.

25.	**Metan i Monometil-diklordifenilit;** *(Monomethyl-dichloro-diphenyl methane)* Emri tregtar: Ugilec 121 Ugilec 21	Nuk do të vendoset në treg, ose të përdoret, si substancë ose në përzierje. Artikujt që përmbajnë këtë substancë nuk do vendosen në treg.
26.	**Metan i Monometil-dibromodifenilit;** *(Monomethyl-dibromo-diphenyl methane)* **bromobenzilbromotoluene**, përzierjet e izomereve; *(bromobenzylbromotoluene)* Emri tregtar: DBBT Nr. CAS 99688-47-8	Nuk do vendoset të në treg, ose të përdoret, si substancë ose në përzierje. Artikujt që përmbajnë këtë substancë nuk do të vendosen në treg.
27.	**Nikeli dhe komponimet e tij** *(Nickel and its compounds)* Nr. CAS 7440-02-0 Nr EC 231-111-4	1. Nuk do të përdoren: a) në çdo montim të mëvonshëm që vendoset në veshët e shpuar dhe pjesë të tjera të shpuara të trupit të njeriut përveç rasteve kur norma e çlirimit të nikelit nga këto montime të mëvonshme është më pak se 0,2 µg/cm²/javë (kufiri i lëvizjes); b) në artikujt e parashikuar për të hyrë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të zgjatur me lëkuren nëse norma e çlirimit të nikelit nga pjesët e këtyre artikujve është më e madhe se 0,5 µg/cm²/javë, si p.sh.: i. vathët, ii. varëset, byzylykët dhe zinxhirët, unazat, byzylykët e këmbës, iii. kapakët e orëve të dorës, rripat dhe shtrënguesit e orëve të dorës, iv. kopsa, shtrëngues, zinxhirë dhe kapëse, kur këto përdoren në veshje. c) në artikujt e referuar në pikën "b", kur këta kanë veshje jonikeli përveç rasteve kur kjo veshje metalike është e mjaftueshme për të siguruar që norma e çlirimit të nikelit nga pjesët e artikujve që hyjnë në kontakt direkt dhe të zgjatur me lëkurën nuk e kalon 0,5 µg/cm²/javë për një periudhë të paktën 2-vjeçare të përdorimit normal të artikullit. 2. Artikujt që nuk plotësojnë kushtet sipas pikës 1, nuk do të vendosen në treg. 3. "Standardet Evropiane të CEN dhe/ose Standardet Shqiptare (SSH), që janë adoptime të Standardeve Evropiane (EN), të miratuara nga DPS, do të përdoren si metoda prove për të demonstruar/treguar përputhshmërinë e artikujve sipas pikës 1 dhe 2".
28.	Substancat që shfaqen në pjesën 3, të shtojcës VI, të vendimit për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, të klasifikuara, si: *kancerogjene, kategoria 1A ose 1B ose në kategorinë kancerogjene 1 ose 2*, dhe që gjenden në kapitullin 2, të kësaj shtojce:	Pa rënë ndesh me pjesët e tjera të kësaj shtojce, hyrjet 28-39: 1. Nuk do të vendosen në treg, ose përdoren: a) si substancë,

29. **30.**	– Kategoria kancerogjene 1A/1. (Tabela 1); – Kategoria kancerogjene 1B/2. (Tabela 2); Substancat që shfaqen në Pjesën 3, të Shtojcës VI, të vendimit për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, të klasifikuara si *Mutagjene për qelizat embrionale*, *Kategoria 1B/2,* dhe që gjenden në Kapitullin 2, të kësaj Shtojce: – Kategoria Mutagjene 1A/1 (Tabela 3); – Kategoria Mutagjene 1B/2 (Tabela 4); Substancat që shfaqen në Pjesën 3, të Shtojcës VI, të vendimit për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, të klasifikuara si *Toksike për Riprodhimin, Kategoria 1A ose 1B,* dhe që gjenden në Kapitullin 2, të kësaj Shtojce: – Kategoria Toksike për riprodhimin 1A/1 (Tabela 5); – Kategoria Toksike për riprodhimin 1B/2 (Tabela 6);	b) si përzierje, c) si përbërës i substancave të tjera, të destinuara për furnizim ndaj publikut të gjerë ku përqendrimi individual në substancë, ose në përzierje, është më i madh, ose i barabartë se: d) Limiti specifik i përqendrimit i përcaktuar në legjislacionin që mbulon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve (pjesa 3, e shtojcës VI). Furnizuesit, duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg që paketimi i këtyre substancave dhe përzierjeve është qartësisht i lexueshëm dhe i fiksuar mirë si më poshtë vijon: "Përdorimi i kufizuar përveç përdoruesve profesionistë". 2. Pika 1, nuk do zbatohet për: a) produkte mjekësore dhe veterinare të rregulluara nga legjislacioni specifik; b) produkte kozmetike të rregulluara nga legjislacioni specifik; c) produktet e naftës dhe karburantet e mëposhtëm të rregulluara nga legjislacioni specifik: i. lëndët djegëse motorike që mbulohen nga legjislacioni specifik për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel; ii. produkte të naftës minerale e parashikuar për përdorim si karburant në impiante djegieje të lëvizshëm ose të fiksuar; iii. karburantë të shitur në sisteme të mbyllura (p.sh. bombulat e gazit). d) Bojërat e artistëve, që mbulohen nga legjislacioni për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve; e) substancat e listuara në tabelën 11, kolona 1, për aplikimet apo përdorimet e renditura në tabelën 11, kolona 2, në kapitullin 2 të kësaj shtojce. Në rastin kur një datë është specifikuar në kolonën 2, të tabelës 11, përjashtimi do të zbatohet deri në atë datë.
31.	a) **Kreosot;** vaj larje *(Creosote; ëash oil)* Nr. CAS 8001-58-9 Nr. EC 232-287-5 b) Vaj Kreosoti; Nr. CAS 61789-28-4 Nr. EC 263-047-8 c) Distilatet (coal tar), vajrat e naftalenit	1. Nuk do të vendosen në treg, ose të përdoren, si substanca ose në përzierje ku substanca ose përzierja është parashikuar për trajtimin e drurit. Përveç kësaj, druri i trajtuar në këtë mënyrë nuk do vendoset në treg. 2. Pika 1, nuk zbatohet për: a) Substancat dhe përzierjet që mund të përdoren për trajtimin e drurit në instalimet industriale ose nga punëtorë profesionistë për ritrajtimin në vend vetëm nëse ato përmbajnë: i. benzo[a]piren me përqendrim më pak se 50mg/kg (0.005% e peshës) dhe,

	Nr. CAS 84650-04-4 Nr. EC 283-484-8 d) Vaj Kreosoti fraksione të acenaftënit; vaj larje; Nr. CAS 90640-84-9 Nr. EC 283-484-8 Nr. EC 292-605-3 e) Distilate (coal tar), të sipërme; vaj i rëndë antrakseni; Nr. CAS 65996-91-0 Nr. EC 266-026-1 e) vaj Antrakseni Nr. CAS90640-80-5 Nr. EC 292-602-7 g) Acide të katraneve, qymyreve, të papërpunuar/bruto; fenole të papërpunuara/bruto Nr. CAS 65996-85-2 Nr. EC 266-019-3 8. Kreosote, dru Nr. CAS 8021-39-4 Nr. EC 232-419-1 j) vaj i katraneve në temperatura të ulëta, alkaline; mbetje të ekstrakteve (qymyre), katrane alkaline të qymyrit në temperatura të ulëta Nr. CAS 122384-78-5 Nr. EC 310-191-5	ii. fenole të ekstraktueshme nga uji me një përqendrim prej më pak se 3% e peshës. Këto substanca dhe përzierje për përdorim në trajtimin e drurit në instalimet industriale ose nga profesionistë: – mund të vendosen në treg vetëm kur kanë ambalazh me një kapacitet më të madh ose të barabartë me 20 litra; – nuk do të vendosen në treg nëse janë parashikuar për përdorim të përgjithshëm nga konsumatorët. Pa paragjykuar zbatimin e legjislacionit që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg që ambalazhimi i këtyre substancave të jetë i shënuar në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të fiksuar mirë me shënimin: **"**Për përdorim në instalimet industriale ose vetëm për trajtim professional". b) druri i trajtuar në instalime industriale ose nga profesionistë sipas pikës 2 a), i cili është vendosur në treg për herë të parë ose është ritrajtuar në vend, mund të përdoret vetëm për përdorim industrial dhe profesional, p.sh. në hekurudha, në transmetimin e fuqisë elektrike (shtyllat e tensionit) dhe telekomunikacion, për gardhet, për qëllime bujqësore, në porte dhe rrugë detare; c) Ndalimi në pikën 1, mbi vendosjen në treg nuk zbatohet për drurin që është trajtuar me këto substanca përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe ky dru vendoset në tregun e dorës së dytë për ripërdorim. 3. Druri i trajtuar, referuar në pikat 2 b) dhe c) nuk do të përdoret: a. brenda ndërtesave, pavarësisht qëllimit të tyre; b. në lodra; c. në parqe lojërash; d. në parqe, kopshte, dhe në ndërtesa të jashtme ku kalohet koha e lirë, ku ka një risk të kontaktit të vazhdueshëm me lëkurën; e. për prodhimin e mobilieve të kopshtit si p.sh. tavolina pikniku; f. për prodhimin dhe përdorimin e çdo ritrajtimi të: i. kontejnerëve të parashikuar për qëllime rritjeje; ii. ambalazhimeve që mund të hyjnë në kontakt me lëndët e para, produktet e ndërmjetme, ose përfundimtare të destinuara për konsumim nga njeriu ose kafshët; iii. materiale të tjera që mund të ndotin artikujt e përmendur më lartë.

32. **34.** **35.** **36.** **37.** **38.**	**Kloroform** Nr. CAS 67-66-3 Nr. EC 200-663-8 **1,1,2- Trikloroetani** ***(****1,1,2-Trichloroethane)* Nr. CAS 79-00-5 EC No 201-166-9 **1,1,2,2- Tetrakloroetani** ***(****1,1,2,2-Trichloroethane)* Nr. CAS 79-34-5 Nr. EC 201-197-8 **1,1,1,2- Tetrakloroetani** ***(****1,1,1,2-Tetrachloroethane)* Nr. CAS 630-20-6 **Pentakloroetani** *(Pentachloroethane)* Nr. CAS 76-01-7 Nr. EC 200-925-1 **1,1- Dikloroeteni** *(1,1-dichloroethene)* Nr. CAS 75-35-4 Nr. EC 200-864-0	1. Nuk do vendosen në treg, ose të përdoren, a. si substancë, b. si përbërës të substancave të tjera, ose në përzierje me përqendrim më të madh ose të barabartë me 0,1% të peshës, ku substanca ose përzierja është parashikuar për furnizim ndaj publikut të gjerë dhe/ose është parashikuar për aplikime difuzive, si në pastrimin e sipërfaqeve dhe pëlhurave. 2. Pa paragjykuar zbatimin e legjislacionit që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg që paketimi i këtyre substancave dhe përzierjeve me përqendrim më të madh ose të barabartë me 0,1% të peshës, të jetë shënuar në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të fiksuar mirë si më poshtë: "Vetëm për përdorim në instalime industriale". 3. Dispozita e pikës 2, nuk zbatohet për: a. produkte mjekësore ose veterinare të përcaktuara nga legjislacioni përkatës; b. produkte kozmetike të përcaktuara nga legjislacioni përkatës.
40.	Substancat që sipas legjislacionit që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, klasifikohen në: – Gaze të ndezshme, kategoria 1 ose 2; – Lëngje të ndezshme, kategoria 1, 2 ose 3; – Substanca të ngurta, kategoria 1 ose 2; – Substanca dhe përzierje, të cilat në kontakt me ujin, çlirojnë gaze të ndezshme, kategoria 1, 2 ose 3; – Lëngje piroforike, kategoria 1 ose substanca të ngurta piroforike, kategoria 1, pavarësisht nëse gjënden ose jo në Pjesën 3 të Shtojcës VI të vendimit për klasifimin, etiketimin dhe amblazhimin e kimikateve.	1. Nuk do përdoren, si substancë ose përzierje në bombola të aerosoleve ku këto bombula kanë si qëllim furnizimin ndaj publikut të përgjithshëm për qëllime argëtimi dhe dekorative si më poshtë: a. shkëlqyes metali i përdorur kryesisht për dekorim; b. dëbore dhe ngricë artificiale; c. jastëk festimesh; d. aerosol me shirita festive; e. imitim jashtëqitjeje; f. boritë për festime; g. flokë (pambuku) dhe shkuma dekorative; h. rrjeta artificiale; i. bomba kutërbuese. 2. Pa paragjykuar zbatimin e legjislacionit që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg që ambalazhimi i bombolave të aerosolëve të referuara më lartë, të jetë i shënuar në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të fiksuar mirë me shënimin: "Vetëm për përdorues profesionistë". 3. Pika 1 dhe 2, nuk do aplikohet për bombolat e aerosolëve me vëllim më të vogël ose të barabartë me 150 ml, dhe ku emri dhe adresa ose shenja dalluese (*trademark*) i furnizuesit është shënuar në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme/përhershme në paketën e bombolës së aerosolit.

		4. Bombolat e aerosolit, të referuar në pikat 1 dhe 2, nuk do vendosen në treg derisa ato të përmbushin kërkesat e treguara.
41.	**Hekzakloroetani** *(Hexachloroethane)* Nr. CAS 67-72-1 Nr. EC 200-666-4	Nuk do vendoset në treg, ose të përdoret, si substancë ose në përzierje, ku substanca ose përzierja është parashikuar të përdoret për prodhimin dhe përpunimin e metaleve me ngjyra.
43.	**Azokolorantet dhe Azongjyruesit** *(Azocolourants and Azodyes)*	1. Azongjyryesit, të cilat nga copëtimi i reduktuar i një ose më shumë grupeve azotike, mund të çlirojnë një ose disa amina aromatike të listuara në Tabelën 8, të Kapitullit 2, të kësaj Shtojce, në përqendrime të dallueshme, p.sh. mbi 30 mg/kg (0,003% të peshës) në artikujt ose në pjesët e tyre të lyera, sipas metodave të testimit të listuara në Tabelën 10, Kapitulli 2, të kësaj Shtojce, nuk do të përdoren (azobojërat) në artikujt e tekstilit dhe lëkurës që hyjnë në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të zgjatur/vazhdueshëm me lëkurën e njeriut ose me kavitetin oral si p.sh.: a. rroba, mbulesa krevati, peshqirë, kapëse flokësh, paruke, kapele, pelena dhe sanitare të tjera, çanta gjumi; b. veshje për këmbë (këpucë, sandale etj.), doreza, rripa të orëve të dorës, çanta dore, portofola/kuleta, valixhe pune, mbulesa karrigesh, çanta që hidhen rreth qafës; c. lodra prej tekstili dhe lëkurë dhe lodra që përmbajnë rroba lëkure dhe tekstile; d. fije dhe pëlhura që kanë si qëllim përdorimin nga konsumatori i fundit. 2. Përveç kësaj, artikujt prej tekstili dhe lëkure të referuar në pikën 1, nuk do të vendosen në treg, derisa të përmbushin kërkesat e përcaktuara aty. 3. Azongjyruesit, të cilët ndodhen në tabelën 9, kapitulli 2, të kësaj shtojce (lista e azongjyruesve), nuk do vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë, ose në përzierje me përqendrim më të madh se 0,1% të peshës, ku substanca ose përzierja ka si qëllim ngjyrosjen e artikujve tekstile dhe prej lëkure.
45.	**Difenileter, derivatet e oktabromit,** $C_{12}H_2Br_8O$ *(Diphenylether, octabromo derivative)*	1. Nuk do vendoset në treg, ose përdoret, a. si substancë; b. si përbërës i substancave të tjera, ose në përzierje me përqendrim më të madh se 0,1% të peshës. 2. Artikujt nuk do vendosen në treg nëse ata, ose pjesë të tyre flakë-ngadalësuese/vonuese, përmbajnë këtë substancë në përqendrim më të madhe se 0,1% të peshës. 3. Pika 2, nuk zbatohet për: a. artikujt që kanë qenë në përdorim përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi; b. pajisjet elektrike dhe elektronike të rregulluara me legjislacion specifik.
46.	**a) Nonilfenol** *(Nonylphenol)* $C_6H_4(OH)C_9H_{19}$	1. Nuk do vendosen në treg, ose të përdoren, si substancë ose në përzierje me përqendrime më të mëdha ose të barabarta me 0,1% të

	Nr. CAS 25154-52-3 Nr. EC 246-672-0 **b) Etoksilate Nonilfenoli** *(Nonylphenol ethoxylates)* $(C_2H_4O)nC_{15}H_{24}O$	peshës, për qëllimet e mëposhtme: a) pastrimin industrial dhe institucional, me përjashtim të: -sistemeve të kontrolluara të pastrimit kimik ku detergjenti larës riciklohet ose digjet/incinerohet, -sistemeve të pastrimit me trajtim special ku detergjenti larës riciklohet ose digjet/icinerohet; b) pastrim shtëpiak; c) përpunim i lëkurës dhe tekstileve, me përjashtim të: -përpunimit, pa çlirimin e mbetjeve në ujë, -sistemeve me trajtim special ku uji i procesit është i trajtuar paraprakisht për të hequr plotësisht pjesët organike përpara trajtimit biologjik të ujërave të zeza; d) emulsifikues në zhytjen e thithkave në bujqësi; e) përpunim metalesh përveç: përdorimeve në sisteme të kontrolluara të mbyllura ku detergjenti larës riciklohet ose incinerohet/digjet; f) prodhim të tulit dhe letrës; g) produkte kozmetike; h) produkte të tjera të kujdesit personal përveç: spermicideve; a) bashkë-formulantët në pesticide dhe biocide Nëse autorizimi për produktet biocide dhe pesticidet që përmbajnë etoksilate nonilfenoli, është dhënë përpara se ligji mbi produktet biocide dhe ligji mbi produktet e mbrojtjes së bimëve të hynte në fuqi, ky ndalim do të aplikohet pas datës së skadimit të atij autorizimi.
46a.	**Etoksilate Nonilfenoli** *(Nonylphenol ethoxylates(NPE))* $(C_2H_4O)nC_{15}H_{24}O$	1. Nuk do të vendoset në treg pas 3 shkurtit 2021 në artikujt e tekstilit të cilat në mënyrë të arsyeshme pritet të lahen në ujë gjatë ciklit të tyre normal të jetës, në përqendrime të barabarta ose më të mëdha se 0.01% të peshës së atij produkti tekstili ose të çdo pjese të produktit të tekstilit. 2. Pika 1 më sipër, nuk zbatohet për vendosjen në treg të produkteve të tekstilit të përdorura ose të produkteve të rinj të prodhuar, pa përdorimin e NPE, ekskluzivisht nga tekstilet e ricikluara. 3. Për qëllime të pikës 1 dhe 2, "produkt tekstili" nënkupton çdo produkt të papërfunduar, gjysmë të përfunduar ose të përfunduar i cili përbëhet nga të paktën 80% fibra tekstile sipas peshës ose ndonjë produkt tjetër që përmban një pjesë e cila përbëhet së paku nga 80% fibra tekstile të peshës së tij, duke përfshirë produkte të tilla si veshje, pajisje, tekstile të brendshme, fibra, fije, pëlhura dhe panele të thurura.
47.	**Komponimet e Kromit VI** *(Chromium VI compounds)* Çimento	1. Çimentoja, dhe përzierjet që përmbajnë çimento, nuk do vendosen në treg, ose përdoren, nëse kur hidratohen përmbajnë më shumë se 2 mg/kg (0.0002%) krom VI, të tretshëm, të peshës totale të thatë të çimentos, nga data 1 korrik 2019. 2. Nëse përdoren agjentët reduktues, pa paragjykuar legjislacionin që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg që në ambalazhin e çimentos, ose të përzierjeve që përmbajnë çimento, në mënyrë të dukshme, të lexueshme qartë dhe të fiksuar mirë është dhënë informacioni mbi datën e ambalazhimit, kushtet e magazinimit dhe

		periudhën e përshtatshme të magazinimit për të mirëmbajtur aktivitetin e agjentëve reduktues dhe për të mbajtur sasinë e kromit VI, të tretshëm, nën limitin e treguar në pikën 1. 3. Ndalimet referuar në pikat 1 dhe 2, nuk zbatohen për vendosjen në treg dhe përdorimin, në procese të mbyllura, të kontrolluara dhe tërësisht të automatizuara, në të cilët çimentoja dhe përzierjet që përmbajnë çimento trajtohen vetëm nga makineri, në të cilat nuk ka mundësi depërtimi në kontakt me lëkurën. 3. *Standardet Evropiane të CEN dhe/ose Standardet Shqiptare (SSH), që janë adoptime të Standardeve Evropiane (EN), të miratuara nga DPS* për testimin e tretshmërisë në ujë të Kromit (VI), që gjendet në çimento dhe përzierjet që përmbajnë çimento, do të përdoren si metoda prove për të treguar përputhshmërinë me pikën 1. 4. Arktikujt prej lëkure që bien në kontakt me lëkurën, nuk do vendosen në treg nëse përmbajnë krom VI në përqendrime të barabartë ose më të madhe se 3 mg/kg (0,0003 % e peshës) e peshës totale të thatë të lëkurës. 5. Artikujt që përmbajnë pjesë lëkure, që bien në kontakt me lëkurën, nuk do vendosen në treg nëse ndonjë nga pjesët e lëkurës përmban krom VI në përqendrime të barabarta ose më të madha se 3 mg/kg (0,0003 % e peshës) e peshës totale të thatë e asaj pjese lëkure. 6. Pikat 5 dhe 6, nuk zbatohen për vendosjen në treg të artikujve të dorës së dytë që kanë qenë në fund të përdorimit përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
48.	**Tolueni** *(Toluene)* Nr. CAS 108-88-03 Nr. EC 203-625-9	1. Nuk do vendoset në treg, ose përdoret, si substancë ose në përzierje, me përqendrim më të madh ose të barabartë me 0,1% të peshës ku substanca ose përzierja është përdorur në ngjitës ose në bojëra spraji me qëllim furnizimin ndaj publikut të përgjithshëm.
49.	**Triklorobenzeni** *(Trichlorobenzene)* Nr. CAS 120-82-1 Nr. EC 204-428-0	1. Nuk do vendoset në treg, ose përdoret, si substancë ose në përzierje, me përqendrim më të madh ose të barabartë me 0,1% të peshës, përveç rastit kur përdoret: a. si një ndërmjetës i sintezës, ose, b. si një tretës në aplikime të mbyllura kimike për reaksionet e klorinimit, ose, c. në prodhimin e 1,3,5-triamino—2,4,6-trinitrobenzenit (TATB).
50.	**Hidrokarburet Policiklike Aromatike:** *(Polycyclic-aromatic hydrocarbons (PAH))* a) (Benzo(a)pireni, BaP) Nr. CAS 50-32-8 b) (Benzo(e)pireni, BeP)	1. Nga data 1 mars 2012, vajrat e zgjerimit nuk do vendosen në treg, ose të përdoren për prodhimin e pjesëve të gomave që përmbajnë: a. më shumë se 1 mg/kg (0,001% të peshës) BaP, ose; b. më shumë se 10 mg/kg (0.01% të peshës) të shumës së të gjithë PAH-ve të listuara.

	Nr. CAS 192-97-2 c) Benzo(a)antrakseni (BaA) Nr. CAS 56-55-3 d) Krizen *(Chrysen, (CHR))* Nr. CAS 218-01-9 e) Benzo(b)fluorantene (BbFA) Nr. CAS 205-99-2 f) Benzo(j)fluorantene (BjFA) Nr. CAS 205-82-3 g) Benzo(k)fluorantene (BkFA) Nr. CAS 207-08-9 h) Dibenzo(a, h)anthracene (DBAhA) Nr. CAS 53-70-3	Standarti EN 16143 (produktet e naftës— Përcaktimi i përmbajtjes së Benzo(a)pirenit (BaP) dhe Hidrokarburet aromatike policiklike të përzgjedhura (PAH) në vajrat e zgjerimit— Procedurë që përdor pastrues të dyfishtë LC dhe analizë GC/MS) do të përdoren si metoda testimi për të provuar përputhshmërinë me limitet e referuar në paragrafin e parë. Këto limite konsiderohen si të mbajtura, nëse ekstrakti i aromatikeve policiklike përbën më pak se 3% të peshës së matur nga Instituti i Hidrokarbureve standardi IP346: 1998 (përcaktimi i PCA në vajrat bazë lubrifikues të papërdorur dhe pjesëve të asfaltenit që nuk përmbajnë naftë – metoda treguese e nxjerrjes refractive të dimetil sulfoksidit), me kusht që përputhshmëria me vlerat limit të BaP dhe të PAH-ve të listuara, si dhe korrelacioni i vlerave të matura me ekstraktin PCA, kontrollohet nga prodhuesi ose importuesi çdo 6 muaj, ose pas çdo ndryshimi madhor operacional, kushdo që ndodh më shpejt. 2. Gomat dhe siperfaqet e gomave për gomat e rimbushura të prodhuara pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk do vendosen në treg nëse përmbajnë Vajra zgjerues që kalojnë limitet e treguara në pikën 1. "Në këto limite konsiderohen si të mbajtura, nëse përbërjet e gomave vullkanike nuk kalojnë limitin e 0,35% të protoneve Bay të matura dhe të llogaritura sipas standardit ISO 21461 dhe/ose SSH ISO 21461 (Gome vullkanike-Përcaktimi i aromaticitetit të naftës/vajit në përbërjet e gomës vullkanike)". 3. Pika 2, nuk zbatohet për gomat e rimbushura, nëse sipërfaqja e gomave të tyre nuk përmban vajrat zgjerues që kalojnë limitet të cilave iu referuam në pikën 1. 4. Për qëllime të kësaj hyrjeje 'gome' i referohet gomës për automjetet e cila mbulohet nga: a. legjislacioni që rregullon miratimin e mjeteve motorike dhe rimorkiot e tyre dhe sistemet e komponentëve dhe njësitë e këmbyeshme të parashikuar për këto mjete; b. legjislacioni që rregullon miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë ose të pylltarisë, rimorkiot e tyre dhe makineri të këmbyeshme tërheqëse, së bashku me sistemet e komponentëve të tyre dhe njësive të veçanta; dhe c. legjislacioni që rregullon miratimin e tipit të mjetit motorik me dy ose tri rrota. 5. Artikujt nuk do vendosen në treg për furnizim ndaj publikut të përgjithshëm, nëse ndonjë nga komponentët e tyre plastik ose prej gome, që bien në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të zgjatur (vazhdueshëm) ose të ripërsëritur me afat të shkurtër me lëkurën ose me kavitetin oral, nën kushte normale ose të arsyeshme të parashikuara të përdorimit, përmbajnë më shumë se 1 mg/kg (0,0001% sipas peshës së këtij përbërësi) të ndonjë nga PAHs e listuara. Këto artikuj ndër të tjera përfshijnë: a. pajisjet e sportit të tilla si biçikletat, klubet e golfit,

		raketat e tenisit; b. vegla shtëpiake, karro, korniza lëvizëse; c. mjete për përdorim të brendshëm; d. veshje, këpucë, doreza dhe veshje sportive; e. shirita ore, rripa ore, maska, rripa koke. 6. Lodrat, duke përfshirë lodra për aktivitete, si dhe artikuj për kujdesin ndaj fëmijëve, nuk do vendosen në treg, nëse ndonjë nga komponentët e tyre plastik ose prej gome, që bien në kontakt të drejtpërdrejtë dhe të zgjatur (vazhdueshëm) ose të ripërsëritur me afat të shkurtër me lëkurën ose me kavitetin oral, nën kushte normale ose të arsyeshme të parashikuara të përdorimit, përmbajnë më shumë se 0.5 mg/kg (0,00005% sipas peshës së këtij përbërësi) të ndonjë nga PAH e listuara. 7. Pikat 5 dhe 6, nuk zbatohen për artikujt e vendosur në treg për herë të parë përpara datës 1 korrik 2019.
51.	**Ftalatet e mëposhtëme (ose numra të tjerë CAS dhe EC që mbulojnë substancën)** 1. bis (2-etilhekzil) ftalate (DEHP) *(Bis (2-ethylhexyl) phthalate (DEHP))* Nr. CAS 117-81-7 Nr. EC 204-211-0 2. dibutil ftalate (DBP) *(Dibutyl phthalate (DBP))* Nr. CAS 84-74-2 Nr. EC 201-557-4 3. benzil butil ftalate (BBP) *(Benzyl butyl phthalate (BBP))* Nr. CAS 85-68-7 Nr. EC 201-622-7	1. Nuk do përdoren si substanca ose në përzierje, me përqendrime më të mëdha se 0,1% të peshës së materialit të plastifikuar, në artikuj për kujdesin ndaj fëmijëve dhe në lodra. 2. Lodrat dhe artikujt e kujdesit për fëmijën që përmbajnë këto ftalate në një përqendrim më të madh se 0,1% të peshës së materialit të plastifikuar nuk do vendosen në treg. 3. Për qëllime të kësaj hyrje "artikujt e kujdesit për fëmijën", nënkupton çdo produkt që ka si qëllim lehtësimin e gjumit, relaksimin, higjienën, ushqyerjen e fëmijëve ose thithjen nga ana e fëmijëve.
52.	**Ftalatet e mëposhtëme (ose numra të tjerë CAS dhe EC që mbulojnë substancën)** a) di-"isononil" ftalate (DINP) *(Di-'isononyl' phthalate (DINP))* Nr. CAS 28553-12-0 dhe 68515-48-0 Nr. EC 249-079-5 dhe 271-090-9 b) di-"isodecil" ftalate (DIDP) *(Di-'isodecyl' phthalate (DIDP))* Nr. CAS 26761-40-0 dhe 68515-49-1	1. Nuk do përdoren si substanca ose në përzierje, me përqendrime më të mëdha se 0,1% të peshës së materialit të plastifikuar, në lodra dhe artikuj për kujdesin ndaj fëmijës që mund të vendosen në gojën e fëmijëve. 2. Lodrat dhe artikujt e kujdesit për fëmijën që përmbajnë këto ftalate në një përqendrim më të madh se 0,1% të peshës së materialit të plastifikuar nuk do vendosen në treg. 3. Për qëllime të kësaj hyrje "artikujt e kujdesit për fëmijën", nënkupton çdo produkt që ka si qëllim lehtësimin e gjumit, relaksimin, higjienën, ushqyerjen e fëmijëve ose thithjen nga ana e fëmijëve.

	Nr. EC 247-977-1 dhe 271-091-4 a) di-*n*-oktil ftalate (DNOP) *(Di-n-octyl phthalate (DNOP))* Nr. CAS 117-84-0 Nr. EC 204-214-7	
54.	**2-(2-metoksietoksi) etanol (DEGME)** *(2-(2-methoxyethoxy)ethanol (DEGME))* Nr. CAS 111-77-3 Nr. EC 203-906-6	Nuk do vendoset në treg pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si furnizim ndaj publikut të gjerë, si përbërës i bojërave, heqësve të bojërave, agjentëve pastrues, emulsioneve vetë-shkëlqyes ose izoluesve të dyshemeve me përqendrime më të mëdha ose të barabarta me 0,1% të peshës.
55.	**2-(2-butoksietoksi) etanol (DEGBE)** *(2-(2-butoxyethoxy)ethanol (DEGBE))* Nr. CAS 112-34-5 Nr. EC 203-961-6	1. Nuk do vendoset në treg për herë të parë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për furnizim ndaj publikut të gjerë, si një përbërës i bojërave spraj ose pastruesve spraj në bombolat aerosolë me përqendrime më të mëdha ose të barabarta me 3% të peshës. 2. Bojërat spraj dhe pastruesit spraj në bombolat aerosolë që përmbajnë DEGBE dhe nuk plotësojnë kushtet e pikës 1, nuk do vendosen në treg për furnizim ndaj publikut të përgjithshëm. 3. Pa paragjykuar legjislacionin mbi klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg të bojërave, të ndryshme nga bojërat spraj, që përmbajnë DEGBE në përqendrime më të mëdha ose të barabarta me 3% të peshës, të vendosur në treg për përdorim nga publiku i përgjithshëm, të jenë të shënuara në mënyrë të dukshme, të lexueshme qartë dhe të fiksuar mirë si më poshtë: "Mos e përdor në pajisjet e sprajeve të bojërave".
56.	**Metilenedifenil diisocianate (MDI)** *(Methylenediphenyl diisocyanate (MDI))* Nr. CAS 26447-40-5 Nr. EC 247-714-0	1. Nuk do vendoset në treg pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si përbërëse e përzierjeve me përqendrime më të mëdha ose të barabartë me 0,1% të peshës të MDI-ve, për furnizim ndaj publikut të përgjithshëm, me përjashtim të rastit kur furnizuesit sigurojnë përpara vendosjes në treg që: a) përmban doreza mbrojtëse; b) pa paragjykuar legjislacionin mbi klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve është shënuar, në mënyrë të dukshme, të lexueshme qartë dhe të fiksuar mirë, dhe si më poshtë vijon: i. Personat që janë të ndjeshëm ndaj diizocianateve, mund të kenë reaksione alergjike kur përdorin këtë produkt; ii. Personat që vuajnë nga astma, eczema ose nga problemet e lëkurës, duhet të shmangin kontaktin, përfshirë kontaktin e lëkurës, ndaj këtij produkti; iii. Ky produkt nuk duhet të përdoret në kushte të ajrosjes/ventilimit të dobët, me përjashtim të rastit kur përdoret një maskë mbrojtëse me një filtër të përshtatshëm gazi.

		2. Ndalimet e referuara në pikën 1 a), nuk zbatohen për ngjitësit që shkrijnë në nxehtësi.
57.	**Ciklohekzan** *(Cyclohexane)* Nr. CAS 110-82-7 Nr. EC 203-806-2	1. Nuk do vendoset në treg për herë të parë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për furnizim ndaj publikut të përgjithshëm, si një përbërës i ngjitësve me kontakt me bazë neopreni me përqendrime më të mëdha ose të barabarta me 0,1% të peshës, me madhësi ambalazhi më të mëdha se 350 g. 2. Ngjitësit me kontakt, me bazë neopreni, që përmbajnë ciklohekzan dhe nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1, nuk do vendosen në treg për furnizim ndaj publikut të gjerë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi. 3. Pa paragjykuar legjislacionin mbi klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, furnizuesit duhet të sigurojnë përpara vendosjes në treg, që ngjitësit me kontakt me bazë neopreni, që përmbajnë ciklohekzan në përqendrime më të mëdha ose të barabarta me 0,1% të peshës dhe që vendosen në treg për furnizim ndaj publikut të përgjithshëm, të jenë shënuar në mënyrë të dukshme, të lexueshme qartë dhe të fiksuar mirë si më poshtë: a. "Ky produkt nuk duhet të përdoret në kushte të dobëta ajrimi/ventilimi"; b. "Ky produkt nuk duhet të përdoret për shtrimin e tapeteve".
58.	**Nitrat amoni (NA)** *(Ammonium nitrat (AN))* Nr. CAS 6484-52-2 EC No. 229-347-8	1. Nuk do vendoset në treg për herë të parë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi si substancë, ose në përzierje që përmbajnë më shumë se 28% të peshës së azotit në lidhje me nitratin e amonit, me qëllim përdorimin si fertilizues i ngurtë, ose i përbërë, përveç rasteve kur fertilizuesi është në përputhje me dispozitat teknike për fertilizuesit me nitrat amoni, me përmbajtje të lartë azoti. 2. Nuk do vendoset në treg pas datës 1 korrik 2019 si substancë, ose në përzierje që përmbajnë 16% ose më shumë të peshës së azotit në lidhje me nitratin e amonit, përveç furnizimit për: a) përdoruesit profesional dhe shpërndarësit, përfshirë personat fizike ose juridike të licencuar ose të autorizuar nga autoriteti kompetent për të prodhuar dhe vendosur në treg, produkte piroteknike, fishekzjarrë dhe eksplozivë për përdorim civil. b) fermerët për përdorim në aktivitetet bujqësore, prodhim, rritjen e produkteve bujqësore duke përfshirë korrjen, mjeljen, çiftëzimin e kafshëve dhe mbajtjen e tyre për qëllime të mbajtjes në ferma, ose mbajtjen e tokës në gjendje të mirë bujqësore dhe mjedisore, me kohë të plotë ose të pjesshme dhe kjo, jo domosdosmërisht e lidhur me madhësinë e sipërfaqes së zonës; c) personat fizikë ose juridikë të angazhuar në aktivitete industriale si hortikultura, rritja e bimëve në sera,

		mirëmbajtja e parqeve, kopshteve ose fushave të sportit, pylltaria ose aktivitete të tjera të ngjashme. 3. Lidhur me kufizimet në pikën 2, deri më 1 korrik 2019, për arsye socio-ekonomike, mund të zbatohet një limit deri në 20% nga pesha e azotit në lidhje me nitratin e amonit për substancat dhe përzierjet e vendosura në treg.
59.	**Diklorometani** *(Dichloromethane)* Nr. CAS 75-09-2 Nr. EC 200-838-9	1. Heqësit e bojës, të cilët përmbajnë diklormetan në një përqendrim më të madh ose të barabartë me 0,1% të peshës nuk do të: a) vendosen në treg për herë të parë, për furnizim ndaj publikut të përgjithshëm ose ndaj profesionistëve pas datës 1 korrik 2019; b) vendosen në treg për herë të parë, për furnizim ndaj publikut të përgjithshëm ose ndaj profesionistëve pas datës 1 korrik 2019; c) përdoren nga persona fizikë ose ligjorë, përfshirë punëtorët ose sipërmarrësit, punëtorët e pavarur/vetë punësuar që ndërmarrin heqjen e bojës në rrjedhën e aktivitetit të tyre profesional jashtë një instalimi industrial pas datës 1 korrik 2019. 2. Ndalimet e referuara në pikën 1, nuk zbatohen për përdorimin dhe vendosjen në treg, të heqësve të bojës që përmbajnë diklormetan, nga profesionistët e trajnuar. Një profesionist, duhet të jetë i pajisur me një certifikatë që vërteton trajnimin e kryer dhe aftësinë e tij, për të përdorur në mënyrë të sigurt heqësit e bojës që përmbajnë diklorometan. 3. Përveç fushës rregulluese të dispozitave, të shëndetit dhe sigurisë në punë, stërvitja për profesionistët për përdorimin e heqësve të bojës referuar pikës 1, do të përfshijë: a) të qenit në dijeni/ndërgjegjësim të risqeve ndaj shëndetit, vlerësimin dhe menaxhimin e këtyre risqeve, duke përfshirë informacionin mbi zëvendësuesit ekzistente ose proceset, të cilët nën kushtet e tyre të përdorimit janë më pak të rrezikshëm ndaj shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve; b) përdorimi i ajrosjes/ventilimit të duhur; c) përdorimi i pajisjeve personale të përshtatshme mbrojtëse në përputhje me Ligjin mbi shëndetin dhe sigurinë në punë. Punëdhënësit dhe punëtorët e vetëpunësuar mundësisht do të zëvendësojnë diklorometanin me një agjent apo proces kimik i cili, në kushtet e tij të përdorimit, nuk paraqet asnjë rrezik, ose një rrezik më të ulët, për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve. 4. Referuar pikës 1, heqësit e bojës që përmbajnë diklormetan në përqendrime më të mëdha ose të barabarta me 0,1% të peshës, mund të përdoren në instalime industriale vetëm nëse përmbushen kushtet minimale të mëposhtme:

		a) ventilim efektiv në të gjithë zonat e përpunimit, në veçanti për përpunimin në të njomë dhe të thatë të artikujve të hequr: tubi i ventilimit lokal në cisternat e heqjes së bojës i plotësuar nga ventilimi i forcuar në këto zona, me qëllim minimizimin e ekspozimit dhe për të siguruar përputhjen, aty ku është teknikisht e mundur, me limitet përkatëse profesionale të ekspozimit; b) matje për të minimizuar avullimin nga cisternat e heqjes së bojës që përbëhet nga: kapakë për mbulimin e cisternave të heqjes së bojës gjatë ngarkimit dhe shkarkimit, marrëveshje të përshtatshme për ngarkimin dhe shkarkimin për cisternat e heqjes së bojës; dhe cisterna larjeje me ujë ose shëllirë për të hequr tretësit e tepërt pas shkarkimit; c) matje për trajtimin e sigurt të diklormetanit në cisternat e heqjes së bojës që përbëhet nga: – pompat dhe tubat për transferimin e heqësit të bojës në ose nga cisternat e heqjes së bojës; – marrëveshje të përshtatshme për pastrimin e sigurt të cisternave dhe heqjen e llumit; d) pajisje mbrojtëse personale që përputhen me legjislacionin mbi shëndetin dhe sigurinë në punë që përbëhet nga: doreza mbrojtëse të përshtatshme, syze sigurie dhe veshje mbrojtëse; dhe pajisje të përshtatshme mbrojtëse të sistemit respirator ku përputhja me limitet përkatëse profesionale të ekspozimit nuk mund të arrihet ndryshe; e) informacionin e duhur, instruktimin dhe trajnimin për operatorët që përdorin këto pajisje. 5. Pa rënë ndesh me dispozitat e legjislacionit që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, nga data 1 korrik 2019 heqësit e bojërave që përmbajnë diklormetan në një përqendrim më të madh ose të barabartë me 0,1% të peshës, duhet të shënohen në mënyrë të dukshme, të lexueshme qartë dhe të fiksuar mirë si më poshtë: "I kufizuar për përdorim industrial dhe për profesionistë të miratuar - verifiko ku është i lejuar përdorimi".
60.	**Akrilamide** *(Acrylamide)* Nr. CAS 79-06-1	Nuk do vendoset në treg ose të përdoret si një substancë, apo përbërës në përzierje me një përqendrim, të barabartë ose më të madh se 0,1% ndaj peshës për aplikimet e mbushjes pas datës 1 korrik 2019.
61.	**Dimetilfumarat (DMF)** *(Dimethylfumarate)* Nr. CAS 624-49-7 Nr. EC 210-849-0	Nuk do të përdoret në artikuj ose ndonjë pjesë të tyre në përqendrime më të mëdha se 0,1 mg/kg. Artikujt, ose çdo pjesë e tyre, që përmban DMF në përqendrime më të mëdha se 0,1 mg/kg nuk do vendoset në treg.

62.	(a) **Acetat Fenilmerkuri** (*Phenylmercury acetate*) EC No: 200-532-5 CAS No: 62-38-4 (b) **Propionate Fenilmerkuri** *(Phenylmercury propionate*) EC Nr: 203-094-3 CAS Nr: 103-27-5 (c**) Etilhekzanoate Fenilmerkuri** (*Phenylmercury 2-ethylhexanoate*) EC Nr: 236-326-7 CAS Nr: 13302-00-6 (d) **Oktanoate Fenilmerkuri** (*Phenylmercury octanoate)* EC No: - CAS No: 13864-38-5 (e) **Neodekanoate Fenilmerkuri** (*Phenylmercury neodecanoate)* EC No: 247-783-7 CAS No: 26545-49-3	1. Nuk do prodhohen, vendosen në treg ose përdoren si substanca ose në përzierje pas 10 tetorit 2019 nëse përqendrimi i merkurit në përzierje është i barabartë ose më i madh se 0,01% në peshë. 2. Artikujt ose ndonjë pjesë e tyre që përmbajnë një ose më shumë prej këtyre substancave nuk mund të vendosen në treg pas 10 tetorit 2019 nëse përqendrimi i merkurit në artikujt ose në ndonjë pjesë të saj është e barabartë ose më e madhe se 0,01%.
63.	**Plumbi dhe komponimet e tij** *(Lead and its compounds)* Nr. CAS 7439-92-1 Nr. EC 231 100-4	1. Nuk do vendoset në treg, ose të përdoret në pjesë të veçanta artikuj bizhuterish, në rastin kur përqendrimi i plumbit (i shprehur si metal) në këtë pjesë është i barabartë me ose më i madh se 0,05 % e peshës. 2. Për qëllime të pikës 1: a. 'artikuj bizhuterish', përfshijnë bizhuteri dhe artikuj imitues bizhuterish dhe aksesorë flokësh, përfshirë: i. *Byzylykë, varëse dhe unaza,* ii. *Bizhuteri pirsingu,* iii. *Ora dore dhe bizhuteri dore/kyçi,* iv. *Karfica dhe mansheta zbukurimi.* b. 'çdo pjesë e veçantë' që përfshin materiale nga e cila është bërë bizhuteria, si edhe komponentë të veçantë të artikujve të bizhuterive; 3. Pika 1, zbatohet edhe për pjesët e veçanta që vendosen në treg, ose përdoren për bërjen e bizhuterive. 4. Pika 1, nuk zbatohet për: (a) xhamin e kristaltë të rregulluar sipas legjislacionit specifik për etiketimin e xhamit të kristaltë; (b) komponentët e brendshëm të pjesëve përbërëse të orëve, që nuk janë të aksesueshme për konsumatorët; (c) gurët e vlefshëm dhe gjysmë të vlefshëm, josintetik ose të ripunuar (Kodi DM 7103, siç është përcaktuar nga legjislacioni specifik për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore), me përjashtim të rastit nëse janë trajtuar me plumb ose komponimet e tij ose me përzierje që përmbajnë këtë substancë.

		(d) Llaqet (enamels), të përcaktuar si përzierje e qelqëzuar, që rezulton nga shkrirja, qelqëzimi ose skorimi (*sintering*) i mineraleve të shkrira në një temperaturë prej të paktën 500°C. 5. Pika 1, nuk zbatohet për artikujt e bizhuterive të vendosura në treg për herë të parë përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe artikujt e bizhuterive të prodhuara përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi. 6. Pikat 1 deri në 5, të kësaj hyrje, do rishikohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi bazuar në informacionin e ri shkencor të disponueshëm, duke përfshirë dhe alternativat në dispozicion dhe transmetimin e plumbit nga artikujt e referuar në pikën 1, dhe nëse është e përshtatshme do rivlerësohen kushtet për vendosjen në treg të kësaj substance. 7. Nuk do vendoset në treg ose përdoret në artikujt që shiten për publikun e gjerë, nëse përqendrimi i plumbit (i shprehur si metal) në ato artikuj ose pjesë të aksesueshme të tyre është i barabartë me ose më i madhe se 0,05% e peshës dhe, ato artikuj ose pjesë të aksesueshme mundet, që gjatë kushteve normale apo të arsyeshme që parashikohet të përdoren, të vendosen në gojë nga fëmijët. Ky limit nuk zbatohet në rastin kur mund të tregohet se shkalla e çlirimit të plumbit nga artikujt, ose pjesët e aksesueshme të ndonjë artikulli, qoftë i veshur apo jo, nuk kalon 0,05 μg/cm² në orë (ekuivalent me 0,05 μg/g/h), dhe për artikujt e veshur, ku veshja është e mjaftueshme për të siguruar se kjo normë çlirimi nuk është tejkaluar për një periudhë të paktën dy vjet nga përdorimi i atij artikulli sipas kushteve normale apo të arsyeshme që parashikohet. Për qëllime të këtij paragrafi, një artikull apo pjesë e arritshme e një artikulli konsiderohet se mund të vendoset në gojë nga ana e fëmijëve nëse ajo është më e vogël se 5 cm në një dimension ose ka një pjesë të ndashme ose të dalë përpara në këtë madhësi. 8. Pika 7, më sipër nuk zbatohet për: a) Artikujt e bizhuterive të mbuluara nga pika 1; b) xhamin e kristaltë të rregulluar sipas legjislacionit specifik për etiketimin e xhamit të kristaltë; c) gurët e vlefshëm dhe gjysmë të vlefshëm, josintetik ose të ripunuar (Kodi DM 7103, siç është përcaktuar nga legjislacioni specifik për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore), me përjashtim të rastit nëse ato janë trajtuar me plumb ose komponimet e tij ose me përzierje që përmbajnë këtë substancë; d) Llaqet (enamels), të përcaktuar si përzierje e qelqëzuar, që rezulton nga shkrirja, qelqëzimi ose skorimi (*sintering*) i mineraleve të shkrira në një temperaturë prej të paktën 500°C;

		e) Çelësat dhe kyçet, duke përfshirë drynat; f) Instrumentet muzikore; g) Artikujt dhe pjesët e artikujve që përmbajnë aliazhe tunxhi, nëse përqendrimi i plumbit (i shprehur si metal) në këto aliazhe nuk e tejkalon 0.05% të peshës; h) Majat e instrumenteve të shkrimit; i) Artikujt fetar; j) Bateritë e lëvizshme zink-karbon dhe bateritë si buton/të vogla (p.sh. si bateritë e orëve); k) Artikujt që mbulohen nga legjislacioni për: i. ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet; ii. materialet dhe artikujt në kontakt me ushqimet; iii. për sigurinë e lodrave; iv. Për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike. 9. Pikat 7 dhe 8 (e), (f), (i) dhe (j), të kësaj hyrje, do rishikohen pas datës 1 korrik 2019 bazuar në informacionin e ri shkencor të disponueshëm, duke përfshirë dhe alternativat në dispozicion dhe transmetimin e plumbit nga artikujt e referuar në pikën 7, duke përfshirë kërkesat për cilësinë e veshjes, dhe nëse është e përshtateshe do të rivlerësohen kushtet për vendosjen në treg të kësaj substance. 10. Pika 7, nuk zbatohet për artikujt e vendosur në treg për herë të parë përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
64.	**1,4-diklorbenzeni** **(***1,4-dichlorobenzene)* Nr. CAS 106-46-7 Nr. EC 203-400-5	Nuk do vendoset në treg, ose të përdoret, si një substancë, ose si një përbërës i përzierjeve në një përqendrim të barabartë ose më të madhe se 1% të peshës, ku substanca ose përzierja është vendosur në treg për përdorim, ose të përdoret si një pastrues ajri, ose largimin e erërave të këqija në tualete, shtëpi, zyra apo ambiente të tjera të brendshme publike.
65.	**Kripërat inorganike të amonit**	1. Nuk do vendoset në treg, ose të përdoret, në përzierjet e izolimit të celulozës ose në artikujt e izolimit të celulozës pas datës 14 korrik 2020, me përjashtim të rastit nëse çlirimi i amoniakut nga ato përzierje ose artikuj rezulton në një përqendrim më të vogël se 3 ppm të volumit (2,12 mg/m^3) nën kushtet e testimit të specifikuara në pikën 3. Furnizuesi i një përzierje izolimi të celulozës që përmban kripërat inorganike të amonit duhet të informojë marrësin ose konsumatorin për shkallën maksimale të lejuar të ngarkimit të përzierjes së izolimit të celulozës, të shprehur në trashësi dhe densitet. Një përdorues (*downstream user*) i një përzierje izolimi celuloze që përmban kripërat inorganike të amonit duhet të sigurojë që shkalla maksimale e lejueshme e ngarkesës e komunikuar nga furnizuesi nuk është tejkaluar. 2. Si rast përjashtimor, pika 1 më sipër nuk zbatohet për vendosjen në treg të përzierjeve izoluese të celulozës, të destinuara për t'u përdorur vetëm për prodhimin e artikujve izolues të celulozës ose për përdorimin e këtyre përzierjeve në prodhimin e artikujve izolues të celulozës.

		3. Përputhshmëria me kufirin e shkarkimeve të përcaktuara në nënparagrafin e parë të pikës 1 duhet të provohet në përputhje me Specifikimin Teknik CEN/TS 16516 dhe/ose DS/TS 16516", i përshtatur si vijon: (a) kohëzgjatja e testit duhet të jetë të paktën 14 ditë në vend të 28 ditëve; (b) shkarkimet e gazit amon të maten të paktën një herë në ditë gjatë gjithë testit; (c) kufiri i shkarkimeve nuk duhet të arrihet ose tejkalohet në asnjë matje të marrë gjatë testimit; (d) lagështia relative të jetë 90% në vend të 50%; (e) do të përdoret një metodë e përshtatshme për të matur shkarkimin e gazit amonit; (f) shkalla e ngarkimit, e shprehur në trashësi dhe densitet, duhet të regjistrohet gjatë marrjes së mostrave të përzierjeve izoluese të celulozës ose artikujve që duhet të testohen.
66.	**Bisfenol A** CAS No 80-05-7 EC No 201-245-8	Nuk do vendoset në treg në letër termale në një përqendrim të barabartë ose më të madh se 0,02% të peshës, pas 2 janarit 2020.
67.	**Bis(pentabromofenil) eter (decabromodyfenil ether; decaBDE)** CAS No 1163-19-5 EC No 214-604-9	1.Nuk do prodhohet ose vendoset në treg si një substancë e pastër në vetvete pas datës 2 mars 2019. 2. Nuk do përdoret në prodhimin e, ose vendoset në treg në: (a) një substancë tjetër, si një përbërës; (b) një përzierje; (c) një artikull ose ndonjë pjesë të tij, në një përqendrim të barabartë ose më të madh se 0,1% të peshës, pas 2 marsit 2019. 3. Pika 1 dhe 2 nuk do të zbatohen për një substancë, përbërës të një substance ose përzierje tjetër që do të përdoret, ose është përdorur: (a) në prodhimin e një avioni përpara 2 marsit 2027. (b) në prodhimin e pjesëve të këmbimit për njërën nga këto: (i) një avion i prodhuar përpara 2 marsit 2027; (ii) Mjetet motorike që mbulohen nga legjislacioni specifik për mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre dhe sistemet e komponentëve dhe njësitë e këmbyeshme të parashikuar për këto mjete; nga legjislacioni për mjetet bujqësore dhe pyjore ose makineritë, prodhuar para datës 2 mars 2019. 4. Pika 2 (c) nuk zbatohet për sa më poshtë: (a) artikujt e vendosur në treg para datës 2 mars 2019; (b) avionët e prodhuar në përputhje me nënparagrafin 3 (a); (c) pjesët rezervë të avionëve, mjeteve ose makinave të prodhuara në përputhje me nënparagrafin 3 (b); (d) pajisjet elektrike dhe elektronike që mbulohen nga legjislacioni për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike; 5. Për qëllime të kësaj hyrje "avion" nënkupton një nga të mëposhtmet: (a) një avion civil i prodhuar në përputhje me një certifikatë lloji të lëshuar sipas legjislacionit "Për rregullat e përbashkëta në fushën e Aviacionit Civil" (Rregullore (BE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit) ose me një miratim të dizajnit të lëshuar sipas rregullave kombëtare të një Shteti Kontraktues të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) ose për të cilin një certifikatë e vlefshmërisë ajrore është lëshuar nga një Shtet Kontraktues i ICAO sipas aneksit 8 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar; (b) një avion ushtarak.

68.	**Acidi Perfluorooktanoik (PFOA)** CAS Nr 335-67-1 EC Nr 206-397-9 dhe kripërat e tij Çdo substancë që ka lidhje (përfshirë kripërat dhe polimeret e saj) që kanë një grup linear ose të degëzuar perfluoroheptil me formulën $C_7 F_{15}$ - e lidhur direkt me një atom tjetër të karbonit, si një nga elementët strukturorë. Çdo substancë që ka lidhje (përfshirë kripërat dhe polimeret e saj) që kanë një grup linear ose të degëzuar perfluorooktil me formulën $C_8 F_{17}$-, si një nga elementët strukturorë. Substancat e mëposhtme përjashtohen nga ky përcaktim: — $C_8 F_{17}$ -X, ku X = F, Cl, Br. — $C_8 F_{17}$ -C(=O)OH, C 8 F 17 -C(=O)O-X' or C 8 F 17 -CF 2 - X' (ku X' = për çdo grup, përfshin kripërat	1. Nuk do prodhohet ose vendoset në treg si një substancë në formën e pastër në vetvete pas datës 4 korrik 2020. 2. Nuk do përdoret, pas datës 4 korrik 2020, për prodhimin e, ose vendoset në treg në: (a) një substancë tjetër, si një përbërës; (b) një përzierje; (c) një artikull në një përqendrim të barabartë ose më të madh se 25 ppb të PFOA përfshirë kripërat e tij ose 1 000 ppb i një ose i një kombinimi substancash që lidhen me PFOA. 3. Pika 1 dhe 2 do të zbatohen prej: (a) datës 4 korrik 2022 në: (ii) në pajisjet e përdorura për prodhimin e semikonduktoreve; (iii) Bojërat e printimit latex; (b) datës 4 korrik 2023 në: (i) një avion i prodhuar përpara 2 marsit 2027; (ii) Mjetet motorike që mbulohen nga legjislacioni specifik për mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre dhe sistemet e komponentëve dhe njësitë e këmbyeshme të parashikuar për këto mjete; nga legjislacioni për mjetet bujqësore dhe pyjore ose legjislacioni për makineritë, prodhuar para datës 2 mars 2019. (c) datës 4 korrik 2023 në: (i) tekstilet për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet për shëndetin dhe sigurinë e tyre; (ii) membranat e destinuara për përdorim në tekstile mjekësore, filtrim në trajtimin e ujit, proceset e prodhimit dhe trajtimin e rrjedhës; (iii) nano-veshjet e plazmës. (d) 4 korrik 2032 për pajisjet mjekësore të ndryshme nga pajisjet mjekësore implantuese që mbulohen nga legjislacioni specifik "Për pajisjet mjekësore". 4. Pikat 1 dhe 2 nuk do të zbatohen, në rastet që vijojnë: (a) për acidin perfluoroktan sulfonik dhe derivatet e tij, të listuara në pjesën A të shtojcës I të legjislacionit 'Për miratimin e listës së Ndotësve Organik të Qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre"; (b) për prodhimin e një substance, në rastin kur kjo ndodh si një nënprodukt i pashmangshëm i prodhimit të fluorokimikateve me një zinxhir karboni të barabartë ose më të shkurtër se 6 atome; (c) një substancë që do të përdoret ose përdoret si një ndërmjetës i izoluar i transportuar; (d) një substancë, përbërës i një substance ose përzierje tjetër që do të përdoret ose përdoret: (i) në prodhimin e pajisjeve mjekësore implantuese që mbulohen nga legjislacioni specifik "Për pajisjet mjekësore". (ii) në veshjet fotografike që aplikohen në filma, letra ose pllaka printimi; (iii) në proceset foto-litografike për gjysmëpërçuesit ose në proceset etching për gjysmëpërçuesit përbërës; (e) Përzierjet e përqendruara të shkumave kundra zjarrit që u janë vendosur në treg para datës 4 korrik 2020 dhe që do të përdoren, ose janë përdorur në prodhimin e përzierjeve të tjera të shkumave kundra zjarrit. 5. Pika 2 (b) nuk zbatohet për përzierjet e shkumave kundra zjarrit që janë:

		(a) vendosur në treg para datës 4 korrik 2020; ose (b) prodhuar në përputhje me pikën 4 (e), me kusht që, kur përdoren për qëllime trajnimi, shkarkimet e tyre në mjedis minimizohen dhe derdhjet e grumbulluara ruhen në mënyrë të sigurt. 6. Pika 2 (c) nuk zbatohet për: (a) artikujt e vendosur në treg para datës 4 korrik 2020; (b) pajisjet mjekësore implantuese të prodhuara në përputhje me pikën 4 (d) (i) më sipër; (c) artikujt e veshur me shtresat fotografike të përmendura në pikën 4 (d) (ii) më sipër; (d) gjysmëpërçuesit ose gjysmëpërçuesit përbërës të përmendur në pikën 4 (d) (iii) më sipër.
69.	**Methanol** CAS No 67-56-1 EC No 200-659-6	Nuk do të vendoset në treg për publikun e gjerë pas datës 9 maj 2019 në lëngjet e larjes së xhamit ose të shkrirjes, në një përqendrim të barabartë ose më të madh se 0,6% në peshë.
70.	**Oktametilciklotetrasilokzan (D4**) *Octamethylcyclotetrasiloxane (D4)* CAS Nr 556-67-2 dhe EC Nr 209-136-7 **Dekametilciklopentasilokzane (D5)** *Decamethylcyclopentasiloxane (D5)* CAS Nr 541-02-6 dhe EC Nr 208-764-9	1. Nuk do të vendoset në treg në produktet kozmetike të lara në një përqendrim të barabartë ose më të madh se 0,1% ndaj peshës së secilës substancë, pas 31 janarit 2020. 2. Për qëllime të kësaj hyrje, "produkte kozmetike të lara" nënkuptojnë produkte kozmetike siç përcaktohet në legjislacionin për produktet kozmetike, të cilat në kushte normale përdorimi, pas aplikimit janë larë me ujë.
71.	**1-methyl-2-pyrrolidone** (NMP) CAS Nr 872-50-4 EC Nr 212-828-1	1.Nuk duhet të vendoset në treg si substancë në formën e saj të pastër ose në përzierje në një përqendrim të barabartë ose më të madh se 0,3% pas datës 9 maj 2020, përveç nëse prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit e mëvonshëm kanë të përfshirë në raportet përkatëse të sigurisë kimike dhe dokumentin me të dhënat e sigurisë kimike(MSDS), Nivelin e përcaktuar që nuk ka ndikim (DNELs) lidhur me ekspozimin e punëtorëve prej 14,4 mg/m^3 për ekspozimin nga inhalacioni dhe 4,8 mg/kg/ditë për ekspozimin në kontakt me lëkurën (dermal). 2. Nuk duhet të prodhohen, ose të përdoren, si substancë në formën e saj të pastër ose në përzierje në një përqendrim të barabartë ose më të madh se 0,3% pas datës 9 maj 2020, përveç nëse prodhuesit dhe përdoruesit e mëvonshëm marrin masat e duhura të administrimit të rrezikut dhe sigurojnë kushtet operacionale për të siguruar që ekspozimi i punëtorëve është nën DNEL-të e specifikuara në pikën 1 më sipër. 3. Përjashtimisht nga pikat 1 dhe 2, detyrimet e përcaktuara këtu do të zbatohen që nga data 9 maj 2024 në lidhje me vendosjen në treg për përdorim, ose përdorimin, si tretës ose reaktant në procesin e veshjes së telave.

KAPITULLI II
TABELA 1:
SUBSTANCA KANCEROGJENE, KATEGORIA 1A/1.
NUMRI I NDALIMEVE DHE KUFIZIMEVE 28

EMËRTIMI I SUBSTANCAVE	NUMRI INDEX	NUMRI CE	NUMRI CAS	SHËNIME
Trioksidi i kromit (VI)	024-001-00-0	215-607-8	1333-82-0	
Kromatet e Zn, duke përfshirë dhe kromatet e zingut dhe kaliumit;	024-007-00-3			
Monoksidi i Nikelit (I); **oksidi i Nikelit (2)** **Bunsenite (3)**	028-003-00-2	215-215-7 (I) 234-323-5 [2] - [3]	1313-99-1 (1) 11099-02-8 [2] 34492-97-2 [3]	
Dyoksid Nikeli	028-004-00-8	234-823-3	12035-36-8	
Trioksidi i DyNikelit	028-005-00-3	215-217-8	1314-06-3	
Sulfuri i Nikelit (II) [1] **Sulfuri i Nikelit [2]** **Millerite [3}**	028-006-00-9	240-841-2 [1] 234-349-7 [2] -[3]	16812-54-7 [1] 11113-75-0 [2] 1314-04-1 [3]	
Disulfuri i tri nikelit; **Subsulfidi i Nikelit [1]** **Heazlewoodite [2]**	028-007-00-4	 234-829-6 [1] -[2]	 12035-72-2 [2] 12035-71-1 [2]	
Dyhidroksid Nikeli; [1 **Dyhidroksid Nikeli; [2]**	028-008-00-X	235-008-5 [1] 234-348-1 [2]	12054-48-7 [1] 11113-74-9 [2]	
Sulfat Nikeli	028-009-00-5	232-104-9	7786-81-4	
Karbonat Nikeli; **Karbonat me bazë Nikeli *(Basic nickel carbonate);*** **Acid karbonik (*Carbonic acid),* krip nikeli (2+); [1]** **Acid karbonik, kripw nikeli; [2]** **[μ-[carbonato(2-)-O:O']] dihydroxy trinickel; [3]** **[carbonato (2-)] tetrahydroxytrinickel; [4]**	028-010-00-0	 222-068-2 [1] 240-408-8 [2] 265-748-4 [3] 235-715-9 [4]	 3333-67-3 [1] 16337-84-1 [2] 65405-96-1 [3] 12607-70-4 [4]	
Dyklorid Nikeli	028-011-00-6	231-743-0	7718-54-9	
Dynitrat Nikeli; [1] **Acid Nitrik, kripw nikeli; [2]**	028-012-00-1	236-068-5 [1] 238-076-4 [2]	13138-45-9 [1] 14216-75-2 [2]	
Nickel matte	028-013-00-7	273-749-6	69012-50-6	
Baltëra dhe llumra, rafinim elektrolitik i bakrit, dekoperizim, sulfat nikeli	028-014-00-2	295-859-3	92129-57-2	
Baltëra dhe llumra, rafinim elektrolitik i bakrit, dekoperizim	028-015-00-8	305-433-1	94551-87-8	
Nickel diperchlorate; **Acid Perklorik, kripw nikeli (II)**	028-016-00-3	237-124-1	13637-71-3	
Nickel dipotassium bis (sulfate); [1] **Diammonium nickel bis (sulfate); [2]**	028-017-00-9	237-563-9 [1] 239-793-2 [2]	13842-46-1 [1] 15699-18-0 [2]	

Nickel bis (sulfamidate); **Nickel sulfamate**	028-018-00-4	237-396-1	13770-89-3	
Nickel bis (tetrafluoroborate)	028-019-00-X	238-753-4	14708-14-6	
diformat Nikeli; [1] **Acid Formik, kripw nikeli; [2]** **Acid Formik, kripw bakër nikli; [3]**	028-021-00-0	222-101-0 [1] 239-946-6 [2] 268-755-0 [3]	3349-06-2 [1] 15843-02-4 [2] 68134-59-8 [3]	
di(acetat) Nikeli; [1] **acetat Nikeli; [2]**	028-022-00-6	206-761-7 [1] 239-086-1 [2]	373-02-4 [1] 14998-37-9 [2]	
Nickel dibenzoate	028-024-00-7	209-046-8	553-71-9	
Nickel bis(4-cyclohexylbutyrate)	028-025-00-2	223-463-2	3906-55-6	
Nickel (II) stearate; **Nickel (II) octadecanoate**	028-026-00-8	218-744-1	2223-95-2	
Nickel dilactate	028-027-00-3	—	16039-61-5	
Nickel (II) octanoate	028-028-00-9	225-656-7	4995-91-9	
Nickel difluoride; [1] **Nickel dibromide; [2]** **Nickel diiodide; [3]** **Nickel potassium fluoride; [4]**	028-029-00-4	233-071-3 [1] 236-665-0 [2] 236-666-6 [3] - [4]	10028-18-9 [1] 13462-88-9 [2] 13462-90-3 [3] 11132-10-8 [4]	
Nickel hexafluorosilicate	028-030-00-X	247-430-7	26043-11-8	
Nickel selenate	028-031-00-5	239-125-2	15060-62-5	
Nickel hydrogen phosphate; [1] **Nickel bis(dihydrogen phosphate); [2]** **Trinickel bis (orthophosphate); [3]** **Dinickel diphosphate; [4]** **Nickel bis (phosphinate); [5]** **Nickel phosphinate; [6]** **Phosphoric acid, calcium nickel salt; [7]** **Diphosphoric acid, nickel (II) salt; [8]**	028-032-00-0	238-278-2 [1] 242-522-3 [2] 233-844-5 [3] 238-426-6 [4] 238-511-8 [5] 252-840-4 [6] - [7] - [8]	14332-34-4 [1] 18718-11-1 [2] 10381-36-9 [3] 14448-18-1 [4] 14507-36-9 [5] 36026-88-7 [6] 17169-61-8 [7] 19372-20-4 [8]	
Diammonium nickel hexacyanoferrate	028-033-00-6	--------	74195-78-1	
Nickel dicyanide	028-034-00-1	209-160-8	557-19-7	
Nickel chromate	028-035-00-7	238-766-5	14721-18-7	
Nickel (II) silicate; [1] **Dinickel orthosilicate; [2]** **Nickel silicate (3:4); [3]** **Silicic acid, nickel salt; [4]** **Trihydrogen hydroxybis[orthosilicato(4-)] trinickelate(3-); [5]**	028-036-00-2	244-578-4 [1] 237-411-1 [2] 250-788-7 [3] 253-461-7 [4] 235-688-3 [5]	21784-78-1 [1] 13775-54-7 [2] 31748-25-1 [3] 37321-15-6 [4] 12519-85-6 [5]	
Dinickel hexacyanoferrate	028-037-00-8	238-946-3	14874-78-3	
Trinickel bis(arsenate); **Nickel (II) arsenate**	028-038-00-3	236-771-7	13477-70-8	
Nickel oxalate; [1] **Oxalic acid, nickel salt; [2]**	028-039-00-9	208-933-7 [1] 243-867-2 [2]	547-67-1 [1] 20543-06-0 [2]	
Nickel telluride	028-040-00-4	235-260-6	12142-88-0	
Trinickel tetrasulfide	028-041-00-X	—	12137-12-1	
Trinickel bis(arsenite)	028-042-00-5	—	74646-29-0	
Cobalt nickel gray periclase; **C.I. Pigment i zi 25;** **C.I. 77332; [1]** **Cobalt nickel dioxide; [2]** **Cobalt nickel oxide; [3]**	028-043-00-0	269-051-6 [1] 261-346-8 [2] - [3]	68186-89-0 [1] 58591-45-0 [2] 12737-30-3 [3]	
Nickel tin trioxide; **Nickel stannate**	028-044-00-6	234-824-9	12035-38-0	

Nickel triuranium decaoxide	028-045-00-1	239-876-6	15780-33-3	
Nickel dithiocyanate	028-046-00-7	237-205-1	13689-92-4	
Nickel dichromate	028-047-00-2	239-646-5	15586-38-6	
Nickel (II) selenite	028-048-00-8	233-263-7	10101-96-9	
Nickel selenide	028-049-00-3	215-216-2	1314-05-2	
Silicic acid, lead nickel salt	028-050-00-9	—	68130-19-8	
Nickel diarsenide; [1] **Nickel arsenide; [2]**	028-051-00-4	235-103-1 [1] 248-169-1 [2]	12068-61-0 [1] 27016-75-7 [2]	
Nickel barium titanium primrose priderite; **C.I. Pigment i verdhe 157;** **C.I. 77900**	028-052-00-X	271-853-6	68610-24-2	
Nickel dichlorate; [1] **Nickel dibromate; [2]** **Ethyl hydrogen sulfate, nickel (II) salt; [3]**	028-053-00-5	267-897-0 [1] 238-596-1 [2] 275-897-7 [3]	67952-43-6 [1] 14550-87-9 [2] 71720-48-4 [3]	
Nickel (II) trifluoroacetate; [1] **Nickel (II) propionate; [2]** **Nickel bis (benzenesulfonate); [3]** **Nickel (II) hydrogen citrate; [4]** **Citric acid, ammonium nickel salt; [5]** **Citric acid, nickel salt; [6]** **Nickel bis (2-ethylhexanoate); [7]** **2-Ethylhexanoic acid, nickel salt; [8]** **Dimethylhexanoic acid nickel salt; [9]** **Nickel (II) isooctanoate; [10]** **Nickel isooctanoate; [11]** **Nickel bis (isononanoate); [12]** **Nickel (II) neononanoate; [13]** **Nickel (II) isodecanoate; [14]** **Nickel (II) neodecanoate; [15]** **Neodecanoic acid, nickel salt; [16]** **Nickel (II) neoundecanoate; [17]** **Bis(D-gluconato-O^1,O^2) nickel; [18]** **Nickel 3,5-bis (tert-butyl)-4-hydroxybenzoate (1:2); [19]** **Nickel (II) palmitate; [20]** **(2-ethylhexanoato-O)(isononanoato-O) nickel; [21]** **(isononanoato-O) (isooctanoato-O)nickel; [22]** **(isooctanoato-O) (neodecanoato-O)nickel; [23]** **(2ethylhexanoato-O)(isodecanoato-O) nickel; [24]** **(2-ethylhexanoato-O)(neodecanoato-O) nickel; [25]** **(isodecanoato-O) (isooctanoato-O)nickel; [26]** **(isodecanoato-O) (isononanoato-O)nickel; [27]** **(isononanoato-O) (neodecanoato-**	028-054-00-0	240-235-8 [1] 222-102-6 [2] 254-642-3 [3] 242-533-3 [4] 242-161-1 [5] 245-119-0 [6] 224-699-9 [7] 231-480-1 [8] 301-323-2 [9] 249-555-2 [10] 248-585-3 [11] 284-349-6 [12] 300-094-6 [13] 287-468-1 [14] 287-469-7 [15] 257-447-1 [16] 300-093-0 [17] 276-205-6 [18] 258-051-1 [19] 237-138-8 [20] 287-470-2 [21] 287-471-8 [22] 284-347-5 [23] 284-351-7 [24] 285-698-7 [25] 285-909-2 [26] 284-348-0 [27] 287-592-6 [28] 294-302-1 [29] 283-972-0 [30]	16083-14-0 [1] 3349-08-4 [2] 39819-65-3 [3] 18721-51-2 [4] 18283-82-4 [5] 22605-92-1 [6] 4454-16-4 [7] 7580-31-6 [8] 93983-68-7 [9] 29317-63-3 [10] 27637-46-3 [11] 84852-37-9 [12] 93920-10-6 [13] 85508-43-6 [14] 85508-44-7 [15] 51818-56-5 [16] 93920-09-3 [17] 71957-07-8 [18] 52625-25-9 [19] 13654-40-5 [20] 85508-45-8 [21] 85508-46-9 [22] 84852-35-7 [23] 84852-39-1 [24] 85135-77-9 [25] 85166-19-4 [26] 84852-36-8 [27] 85551-28-6 [28] 91697-41-5 [29] 84776-45-4 [30]	

O)nickel; [28] **Fatty acids, C_{6-19}-branched, nickel salts; [29]** **Fatty acids, C_{8-18} and C_{18}-unsaturated, nickel salts; [30]** **2,7-Naphthalenedisulfonic acid, nickel (II) salt; [31]**		- [31]	72319-19-8 [31]	
